

NENDORI

Revistë e përmuajshme
letrare-artistike
shoqërore-politike

ORGAN I LIDHJES SË SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE
TË SHQIPËRISË

Nr. 3 VITI XVIII I BOTIMIT MARS 1971

L E N D A

STUDIME E KRITIKA

	Faqe
PIPI MITROJORGJI HAMIDE STRINGA	3 50
	70

KUJTIME

SALI VERDHA	84
-------------	----

100-VJETORI I KOMUNËS SË PARISIT

EUGJEN POTJE	106
--------------	-----

KRIJIME LETRARE

AGIM CERGA	111
HYSNI MILLOSHI	172
VANGJEL KOZMA	174
NATASHA LAKO	177
IRAKLI PAPA	180
ARQILE NDINI	182
PETRIT KUMI	185

SHKRIMTARË TË KOSOVËS

		Faqe
BRAHMAN DEDAJ	Migjenit — Një pjesë e këngës — N'atë plis, vjersha	193
REXHEP HOXHA	Picimuli ka dëshirë të jetë vizatues i mirë — OXHAKFHSI — Gjumashi, vjersha për fëmijë	195
NEVZETE OMERAGAJ EKREM KRYEZIU	Sot vashat... — Malësorja, vjersha Në muzeumin e Lidhjes së Pri- zrenit, tregim	197 198
ALI ALIU	Konflikti brenda qëndresës dhe vitalitetit, kritikë letrare	205

LETËRSI E HUAJ

AJA HAMIDU	Pavarësi? — Një ministri — Për luftën — Duart e tua, poezi gu- nejane	212
------------	---	-----

BOTIME TË REJA

● Cuca e pavionit ● Këngë në kopsht ● Buzëqeshje ● Një gërshet i shturur	217
---	-----

NGJARJE KULTURALE ARTISTIKE

● Ekspozitë e portretit ● Estradat profesioniste dhe çfaqjet për fëmijë ● Diskutim i festivalit të këngës në Radio-televi- zion ● Diskutimi i «Kështjellës».	225
--	-----

Në kopertinën IV: Petrit Papa «Basketbollistët».

Kryeredaktor: Fatmir Gjata

Kolegjumi i redaksisë: Andon Kuçali (sekretar i kolegjumit),
Dilaver Dilaveri, Dhimitër Xhuvani, Eglantina Mandia, Fatos Arapi,
Gjergj Zheji, Jakov Xoxa, Lavdi Leka, Pandi Meje, Sandër Çefa,
Sterjo Spasse.

DISKUTIME NE PLENUMIN E LIDHJES PER LETERSINE PER FEMIJE

BEDRI DEDJA:

Ta vlerësojmë drejt letërsinë për fëmijë si mjet i fuqishëm i edukimit komunist

Problemi i letërsisë për fëmijë, si një mjet i fuqi-
shëm i edukatës komuniste është bërë në vendin tonë
një çështje e rëndësishme partie dhe shteti. Në këtë lë-
më punojnë me pasion disa forca të kualifikuara e të
reja të frontit tonë krijues. Masa e prindërve, e mësues-
ve, pa folur më për armatat e lexuesve të vegjël, tregoj-
në një interesim shumë të madh për çdo botim të ri
për fëmijë, që tanimë pritet me padurim. Për të gjitha
këto flasin edhe fakte të tjera, siç janë rezultatet e dis-
kutimit të madh popullor për revolucionarizimin e më-
tejshëm të shkollës sonë, në bazë të të cilave u bë një
analizë e shëndoshë kritike në tribunën e masës së po-
pullit për tekstet shkollore dhe gjithë krijimtarinë letra-
re për fëmijë. Për këtë flasin dokumentat dhe vendimet
e partisë për artet dhe letërsinë dhe interesimi i drejt-
përdrejtë i shokut Enver për letërsinë për fëmijë; ai
më se një herë dhe posaçërisht në fjalën e mbajtur në
Konferencën e 17-të të partisë për Tiranën, me porosinë
dhe këshillat e tij të urta, u ka hapur horizonte të reja
forcave krijuese për ta çuar përpara këtë letërsi në shtra-
tin e shëndetshëm të realizmit socialist. Për këtë fakt
flet qartë edhe rritja e vazhdueshme e botimeve për
fëmijë gjatë periudhës së ndërtimit socialist të vendit

tonë: në vitin 1945 u botua tek ne vetëm një vepër origjinale për fëmijë, më 1950 dy vepra, më 1960 nëndë vepra me 186 mijë kopje, ndërsa më 1969 tridhjetë e tëtë vepra origjinale me afro gjysëm milioni kopje.

Cilat kanë qenë fenomenet tipike, që kanë karakterizuar letërsinë tonë për fëmijë në dhjetëvjeçarin e fundit?

Proçesi i zhvillimit të letërsisë sonë të realizmit socialist për fëmijët është karakterizuar këto vitet e fundit nga dy tipare themelore:

Së pari, nga prioriteti absolut, që ka fituar trajtimi i temës aktuale me të gjitha llojet e letërsisë për të vegjël; nuk është aspak e drejtë ajo pikëpamje, që shprehet tek-tuk në ndonjë artikull gazete, se gjoja jemi larg këtij synimi, se paskemi ende tematikë tradicionale për kuklla e kafshë etj. Kjo është një pikëpamje superficiale, që nuk bazohet aspak në njohjen e specifikës së trajtimit të temës aktuale në letërsinë për të vegjëlit. Është e vërtetë se ne kemi ende mungesa në prozën e gjatë për fëmijë, por të pretendosh për temën aktuale në letërsinë për fëmijë, ashtu si edhe në letërsinë për të rritur, do të thotë të mos marrësh mirë parasysh veçoritë psikike të moshës. Bota e madhe politike aktuale e të vegjëlive fillon tamam në atë rrethin e vogël të lodrave me kafshë e kuklla, me tanks e pushkë për të arritur më vonë te realiteti ynë madhështor e revolucionar. Pa këtë nismë nuk mund të arrish tek qëllimi final, pasi e tillë është edhe rruga e zhvillimit psikik të fëmijës. Në këtë prizëm duhen parë përpjekjet e autorëve tanë për trajtimin e temës aktuale;

së dyti, letërsia jonë për fëmijë, si asnjëherë është pasuruar me firma të reja; në këtë lëmë nuk punojnë më kryesisht tre-katër autorë si dhjetë ose pesëmbëdhjetë vjet më parë. Disa prej autorëve dikur fillestarë, tani kanë nisur të hyjnë në rrugën e pjekurisë artistike. Autorë të afirmuar të letërsisë për të rritur sjellin kontribut të çmuar në pasurimin e fondit të letërsisë për të vegjël. Duke u mbështetur në njohjen e veprave për fëmijë dhe tendencat e kësaj letërsie në botë, veçanërisht gjatë 5-6 viteve të fundit, — ne duhet të arrijmë në përfundimin se letërsia jonë për fëmijë, pavarësisht se ende është e pakët, si përmbajtje dhe cilësi artistike në veprat e saj më të mira është një tendencë e shëndetëshme revolucionare, për të cilën ne duhet të krenohemi.

Vepra të tilla si «Gurëgdhendësit» e I. Kadaresë,

«Porosia e fundit e Gjergj Kastriotit» e M. Gurakuqit, «Shpella e piratëve» e P. Markos, vjershat e Xh. Beqarajt, «Pika e ujit» e N. Priftit, vjershat e A. Mamaqit, tregime të N. Jorgaqit, K. Kostës, «Shqipja e kresh-tave tona» e S. Drinit, përralla të B. Gaçes, Gj. Vlasi, krijimet më të mira të O. Grillos, B. Harxhit, S. Këllicit, F. Malos, P. Zotos, R. Pasmaçiu, A. Zekës, F. Topit, A. Micit, G. Bushakës, Ll. Nanos etj. etj., kanë bërë që letërsia jonë për fëmijë të fitojë pjekurinë e saj si tendencë revolucionare e pavarur, si bimë e bukur e plot jetë, me dinjitet të plotë në kopshtin e mrekullueshëm të letërsisë dhe arteve tona, që me aq kujdes e dashuri kanë krijuar shkrimtarët tanë të udhëhequr nga porositë e partisë dhe të shokut Enver.

Po prirja jonë për ta shikuar ngandonjëherë me vështrim të pakënaqur procesin e zhvillimit të letërsisë për fëmijë e ka burimin gjetkë: kjo letërsi, po të shprehemi në mënyrë figurative, ecën me progresin aritmetik, ndërsa kërkesat e lexuesve të vegjël dhe prindërve për të, ecin me progresin gjeometrik; problemet e edukimit të brezit të ri dhe konceptet tona revolucionare për këtë edukim përparojnë çdo ditë dhe letërsia nuk e arrin dot këtë ritëm. Prandaj ndodh që fëmijët i kthejnë prindërit për t'u lexuar për të njëzetën apo të tridhjetën herë po të njëjtin libër. Kjo krijon atmosferën e «urisë» së librave për fëmijë, «urisë» për tematikën e saj të larmishme aktuale. Ky rast që po tregoj më poshtë është një fenomen i çuditshëm, po me fenomene të tilla do të ndeshemi gjithnjë më shumë nesër: një fëmijë kopshti gjashtëvjeçar e detyroi të jëmën brenda dy pasditeve t'i lexonte romanin e S. Jasës «Njësi gueril», pa e shkëputur për asnjë moment vëmendjen. Kërkesat tona të sotme për edukimin jashtë-shkollor të fëmijëve kanë marrë proporcione të mëdha dhe kanë fituar rëndësi të dorës së parë.

Për të kuptuar se sa të gjëra janë problemet dhe temat aktuale që duhet të trajtojë letërsia jonë për fëmijë, mjafton të kujtojmë fjalën e shokut Enver të 13 Majit 1969, nga e cila çdo shkrimtar duhet të nxjerrë konkluzione të rëndësishme për veprimtarinë e vet krijuese.

Shtypi ynë letrar dhe pedagogjik duhet të nxjerrin konkluzione të rëndësishme për punën tonë në ndihmë të letërsisë për të vegjël. Dhe themeloria në momentet aktuale është si t'i ndihmojmë letërsinë për fëmijë dhe

forcat e saj krijuese, shkencërisht që të ecin përpara për të zgjidhur detyrat që na cakton shoku Enver në këtë fjalim, si t'i ndihmojmë shkencërisht dhe sistematikisht, duke mos lejuar në asnjë mënyrë që të merremi me këtë punë vetëm në prag të plenumëve të posaçme dhe si t'i mbyllim rrugën subjektivizmit dhe mosinteresimit, që vërehen ngandonjëherë për këtë letërsi.

Ç'probleme mund të shtroheshin duke u nisur nga këto pozita? Mbi të gjitha, ne duhet ta kuptojmë më mirë se kurrë sot problemin e zhvillimit të letërsisë për fëmijë si një çështje të edukimit ideopolitik të brezit të ri. Edukimi ideopolitik ka fituar sot një rëndësi të jashtëzakonshme, prandaj mjetet e ndikimeve sociale si dhe mjetet e format e punës kulturalo-artistike nuk mund t'i gyykojmë me atë kuptimin e thjeshtëzuar të pedagogjisë tradicionale se, me që shkolla luan rol kryesor dhe drejtues në edukimin e brezit të ri, mund ta flemë mëndjen për të tjerat. Jo, ky do të ishte një qëndrim i gabuar. Në momente të caktuara, roli i ndikimeve sociale dhe format e mjetet e punës kulturalo-artistike mund të kapërcejnë dhe ndikimet e shkollës. Ky është një mësim që ka nxjerrë partia jonë nga taktika djallëzore e revizionizmit modern për degjenerimin e brezit të ri, duke i hapur portat ideologjisë borgjeze pikërisht në mjetet dhe format e punës kulturalo-artistike me brezin e ri, në letërsi, në film, në teatër, në televizion, etj.

Kështu duhet ta kuptojmë porosinë e shokut Enver në fjalën e 7 Marsit 1968, kur thotë: «popullit dhe brezit të ri, qoftë në botimet shkollore apo ato publike, ne duhet t'u japim në duar libra jo për t'i çorientuar ose çoroditur shpirtërisht, po për t'i ndihmuar të njohin zhvillimin e shoqërisë dhe njëkohësisht t'i armatosin me ideologjinë tonë» me qëllim që të mos shkallmojmë natën me duart tona atë që ndërtojmë ditën.

Si paraqitet ky fenomen në botën e sotme, i parë në prizmin e letërsisë për fëmijë dhe nga i cili ne duhet të nxjerrim konkluzionet tona? Në Bashkimin Sovjetik sulmi revizionist për korrupsionin e brezit të ri nuk nisi në fillim në programet dhe tekstet shkollore, por në mjetet dhe format e punës kulturalo-artistike, duke shkelur me këmbë, p.sh., në fushën e letërsisë për fëmijë traditat revolucionare të Gorkit, Majakovskit, Gajdarit etj.

Para tre vjetësh në shtypin letrar sovjetik tregohet rasti i një fëmije të sëmurë nga pikëpamja psikike, që kish rënë viktimë e librave të përbindëshme «fantastiko-shkencore». «Sot unë vizitova të sëmurin... — shkruan mësuesi, — dhe sqarova burimet e kllapisë së tij. Ai më foli për tregimin e J. Kotlarit «Shpagimi», në të cilin shkruhet për vdekjen e zezë — enigmë si dhe për veprën e B. Zubkovit dhe E. Muslinit «Kulla», ku mekanizmi kibernetik në intervalet e punës së vet ushqehet me gjak njeriu... Kjo nuk është gjë, tha solemnisht djali, kam lexuar një libër tjetër ku thepron një bishë e hekurt! Ajo gllabëron vetëm mish të pazier. Njëherë nuk mjaftoi mishi dhe konstruktori e ushqeu atë me gjysmën e dorës së vet... Sëmundja e djalit, vazhdoi mësuesi, është e qartë. Unë gjeta në bibliotekën e djalit afro dhjetë libra të kësaj natyre...» dhe të gjitha këto «vepra» janë botuar në Bashkimin Sovjetik në tirazhe të konsiderueshme gjer në afro çerek milioni kopje, ashtu siç botohen edhe tregimet e biblës. Tani traditat revolucionare të letërsisë sovjetike për fëmijë janë zëvendësuar haptazi me tradita formaliste, dekadente dhe reaksionare. Në referatin «mbi letërsinë për fëmijë» të mbajtur në mars të vitit 1970 në Kongresin e III të shkrimtarëve të R.S.F.S.R. thuhej hapur: «një fatkeqësi shumë më serioze... duken disa tendenca të prirura vetëm në kërkim të formës». Dhe referuesja përmend vjershat ekscentrike për fëmijë, të cilat janë bërë modë me vargje të tilla:

*A e dini ju?
A e dini ju?
A e dini ju?
Sigurisht, e dini!
E qartë që e dini!
Pa dyshim,
Pa dyshim,
Pa dyshim që ju e dini!*

Pohime të tilla jepte edhe revista «Detskaja literatura» në Nr. 8 të vitit 1967, ku thuhej se në letërsinë për fëmijë tani po lundron lirisht njeriu i zakonshëm, i cili ka dalë nga kuadri i jetës shoqërore dhe që preokupohet vetëm me rregullimin e çështjeve personale; në letërsi takohet më shumë njeriu i fyer nga shoqëria se sa krijuesi i jetës shoqërore. Në krijimtarinë letrare të shkrimtarëve të sotëm sovjetikë për fëmijë po zhduken krejtë-

sisht gjurmët e poezisë patriotike revolucionare për të vegjëlit.

Po kështu, zhvillimi i letërsisë për fëmijë këto vitet e fundit në vëndet kapitaliste tregon më së miri se ç'përfundime duhet të nxjerrim ne mbi rolin që luan ky mjet për orientimin e brezit të ri në jetë sipas qëllimeve të klasave sunduese. Në botën perëndimore, përveç komikseve tashmë të njohura, një vënd gjithnjë më të madh po zenë bestselerët, libra që zakonisht tregojnë për fenomene mistike dhe që tanimë kanë invaduar tregun amerikan dhe tregun e vëndeve të Europës Perëndimore, të Anglisë, Italisë, Suedisë, Danimarkës etj. Në Gjermaninë Perëndimore këto lloj botimesh arrijnë në treqind e trembëdhjetë milion kopje në vit. Me ndihmën e reklamave të panumërta, këto libra paraqiten si tekste të jetës, si udhërrëfenja për të mësuar artin e përdorimit të pistoletës dhe të fabrikimit të kufomave. Një veçori tjetër e kësaj letërsie është thellimi i mëtejshëm i karakterit pornografik. Kështu, p.sh., të gjitha librat e shtëpisë botuese amerikane «Grouv-press» në dhjetëvjeçarin e fundit kanë si leitmotiv kryesor të ashtuquajturin «Revolucionin e dytë seksual» dhe fitoren e arritur në betejën kundër «Cenzurës morale». Jo më kot, duke u nisur nga kjo bazë, njëfarë Henri Miler para disa kohësh pat deklaruar se tanimë «beteja për emancipimin seksual në letërsi është fituar...» Për një vepër të kësaj natyre të botuar me pseudonimin Henri Satton dhe të titulluar «Eksgibicionist» një kritik pat deklaruar se nuk do të pranonte ta prekte as me një shkop me gjatësi prej 40 futësh, vetëm e vetëm për fjalët e ndyra dhe sharjet që libri përmban brenda. Bestselerët dhe komikset shkruhen nga disa autorë jo me pendë, po me lopata. Vetë shtypi borgjez është i detyruar herë pas here të shfaqë shqetësime për dëmin e madh të këtyre botimeve.

Duke u nisur nga analiza shkencore marksiste e fenomeneve të kësaj natyre, plenumi i 8-të i KQ të PPSH kushtuar konkluzioneve të diskutimit popullor për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës përcaktoi një platformë të qartë për detyrat e frontit kulturalo-artistik në edukimin e brezit të ri. «Në gjithë këtë punë, — thuhet në raportin e Plenumit, — duhet të forcohet shumë drejtimi i partisë, sidomos në luftën kundër influencës së ideologjisë borgjeze dhe revizioniste, kundër depërtimit të influencës borgjeze e revizioniste në më-

nyrën e jetesës, kundër shijes dhe modës borgjeze. Në këtë vështrim e gjithë krijimtaria dhe veprimtaria jonë letrare, botuese, artistike e kulturele duhet të militojnë më fuqishëm e më me tendenciozitet për edukimin komunist të rinisë».

Kështu duhet ta kuptojmë ne aktualisht rolin e letërsisë për fëmijë në edukatën ideopolitike të brezit të ri si dhe përgjegjësinë e forcave krijuese, që punojnë në këtë fushë.

Në radhë të dytë, është e nevojshme që të luftojmë për të krijuar një ambjent më të ngrohët, më inkurajues dhe më favorizues për shkrimtarët që debutojnë në fushën e letërsisë për fëmijë dhe që ata t'i kuptojnë më mirë këto probleme. Në qëndrimin ndaj kësaj letërsie i duhet dhënë fund tonit të ftohët akademik për vlerësimin e gjërave, disa koncepteve jo shumë të drejta, që nxjerrin kokën aty-këtu, me synim që procesin e zhvillimit të kësaj letërsie ta shohim me sy realist dhe dialektik.

Ngandonjëherë për këtë letërsi gjykohet me mospërfillje, veçanërisht në disa shkrime kritike të shtypit letrar. Në këto shkrime ndikojnë edhe disa koncepte dhe fenomene që duhet t'i luftojmë, ose t'i trajtojmë më drejt. Kështu, p.sh. ndonjë kritik theksin e shqetësimeve të veta për këtë letërsi e ve tek bota intelektuale e fëmijëve të sotëm, tek zgjerimi i interesave të tyre etj. etj., të cilat nuk gjejnë pasqyrimin e duhur në përshtatjen e veprave lexuesve të vegjël. Kjo është e vërtetë gjer në një farë shkalle, por po ta vësh theksin gjithnjë vetëm këtu dhe të harrosh kryesoren, edukimin ideopolitik dhe kërkesat që kemi sot ndaj tij, po të lesh më një anë se letërsia për fëmijë duhet t'i përgjigjet, në radhë të parë, pjekurisë së herëshme politike të fëmijëve, siç thotë shoku Enver në Konferencën e 17-të të Partisë për Tiranën, do të thotë ta shikosh këtë letërsi nga pozitrat e intelektualizmit borgjez dhe të mos kuptosh se cili aspekt i edukatës komuniste ka prioritet në kushtet aktuale.

Nga ana tjetër, çfaqet mendimi se kritika e letërsisë për fëmijë tek ne, në përgjithësi, i vlerëson drejt veprat në këtë fushë. Shprehet pikëpamja se ajo e ndihmon të ecë përpara zhvillimin e kësaj letërsie. Neve na duket se shqetësimi kryesor i organizatës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve pikërisht këtu duhet të çfaqet: sa e ndihmon kritika letrare që të ecë përpara këtë pro-

ces, sa ndihmon organizata jonë me mundësitë e veta organizative dhe materiale për ta çuar përpara letërsinë për fëmijë? Ai që e ka ndjekur me vëmendje kritikën mbi veprat për fëmijë, nuk e ka të vështirë të nxjerrë konkluzionin se në të predominon vlerësimi negativ, toni konkluziv, filozofues, ntrashja e të metave. Disa autorë me përvojë, që debutonin në këtë fushë, ka kohë që heshitin. megjithëse i kanë mundësitë krijuese. Ka nga ata që provojnë e debutojnë ndonjëherë dhe pastaj pohojnë hapur se për këtë letërsi nuk interesohet kush, se më pak se kushdo autorët për fëmijë marrin leje krijuese dhe se asqë mund të mendohet që një shkrimtar për fëmijë mund të dalë në profesion të lirë.

Të gjitha këto duhen konsideruar koncepte dhe mendime të gabuara. Sigurisht, si Ministria, si Lidhja mund të lozin një rol drejtues më të mirë për këto probleme dhe të krijojnë kushte më të favorëshme për autorët që shkruajnë për të vegjëlit. Po kjo nuk është as themelore dhe as vendimtare. Ne duhet të synojmë që krijimtaria për fëmijë të bëhet një çështje e përditëshme e vetë subjektit shkrimtar, duke i specializuar forcat në këtë fushë, duke i ndihmuar ata që të merren sistematikisht me këtë letërsi dhe pse jo edhe duke i inkurajuar pa sarafllëk. Për t'ia arritur këtij qëllimi duhet të lozin një rol të madh Komiteti i Kulturës dhe Arteve si dhe drejtoritë arësimore të Ministrisë së Arësimit e të Kulturës, Komisioni i letërsisë për fëmijë pranë Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve si dhe Redaksia e letërsisë për fëmijë dhe të rinj pranë Shtëpisë Botuese «Naim Frashëri». Të gjithë këta nuk duhet të presin spontanisht se ç'shkruhet dhe ç'vjen për botim për fëmijë, por duhet ta marrin në dorë me forca të përbashkëta drejtimin shtetëror dhe organizimin e procesit krijues në fushën e kësaj letërsie me të gjitha forcat edhe mjetet.

Në gjykimin e veprave për fëmijë duhet të jemi më realistë edhe përsa u përket diskutimeve mbi nivelin artistik. Me sa shohim nga botimet e këtyre 5 vjetëve të fundit për fëmijë nëpër botë, pa folur për përmbajtjen degjeneruese, nuk ka fenomene të letërsisë për fëmijë edhe përsa i përket nivelit artistik. Pa ulur kërkesat për këtë nivel, siç na mëson partia, nuk kemi pse të biem në pesimizëm për veprat tona, qoftë dhe ato që përmendëm më lart, të cilat qëndrojnë denjësisht barazi me veprat më të mira të gjithë letërsisë sonë të realizmit socialist. Në rast se ne nuk na kënaqin të gjitha

botimet për fëmijë dhe të gjitha shkrimet e një përmbledheje për fëmijë, kjo ngjet natyrshëm, ashtu siç nuk na kënaqin edhe të gjitha botimet për të rritur. Po pse, atëhere, për të dytat artikujt dhe përshtypjet e lexuesve rrjedhin si lumë nëpër gazetën «Drita», kurse për të parat fjalët shkruhen me shumë kursim? Mund të ketë edhe kjo arsësyet e veta objektive, të cilat duhet t'i kenë parasysh gjithnjë shkrimtarët për fëmijë: veprat e tyre bëjnë që të rrjedhin si lumë emocionet dhe mirënjohja e fëmijëve nëpër shkolla dhe kopshte. Kjo është një kënaqësi specifike, që duhet ta shtyjë shkrimtarin për fëmijë të punojë me ngulm, me pasion, me idealin e partisë në gji, pa pritur inkurajimet e kritikës.

Megjithatë, edhe nga këto që u thanë ne duhet të nxjerrim konkluzione dhe procesin krijues në fushën e letërsisë për fëmijë ta shohim realisht. Në rast se në pikëpamje të nivelit artistik, letërsia për të rritur e mori stafetën nga mjeshtra të tillë si Naimi, Çajupi, Mjeda, Noli, Migjeni etj., letërsia për fëmijë e mori stafetën nga shkrimet didaktike — moralizuese për librat e këndimit të shkollave dhe hapi që i është dashur të bëjë asaj kaqenë më i rëndë dhe shumë më i vështirë.

Edhe ngritja teorike, ideologjike e profesionale e shkrimtarëve dhe letrarëve për fëmijë, ashtu si edhe e punonjësve të enteve botuese, të radios, të televizionit, të Kinostudios, të teatrit për fëmijë, të estradës etj. duhet bërë me kritere më të drejta nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve në bashkëpunim me Ministrinë e Arësimit e Kulturës, KQ të BRPSH dhe Shtëpinë Botuese «N. Frashëri». Sigurisht, është gjë e mirë që megjithë shkrimtarët e artistët zhvillohen tema të përgjithëshme në bazë të planit të organizatës sonë për ngritjen ideoprofesionale, po veç kësaj duhet bërë edhe punë e diferencuar me këto forca, duhen edhe tema të veçanta, p.sh., për ata që shkruajnë për fëmijë, pasi kanë halle dhe nevoja specifike. Këta duhet të njohin më mirë pedagogjinë dhe psikologjinë e sotme, teorinë e letërsisë për fëmijë etj.

Të gjitha këto besojmë se do të japin një ndihmë të çmuar për t'i çuar përpara forcat krijuese të letërsisë dhe arteve për të vegjëlit. Dhe, siç thuhet në Përsëndetjen e Komitetit Qendror të PPSH drejtuar shkrimtarëve dhe artistëve me rastin e 25-vjetorit të themelimit të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë për sukseset gëzohen dhe do të gëzohen gjithnjë «të gjithë, që nga kalamani e deri tek më plaku».

Aktualiteti në veprat e letërsisë për fëmijë

Është fakt që në periudhën midis këtyre dy plenu-
meve, letërsia jonë për fëmijë ka pasur një ngritje të
madhe në nivelin e saj të përgjithshëm, kryesisht në
drejtim të zgjerimit të diapazonit tematik, i cili po
vjen duke u shtrirë, duke u thelluar e duke u prirë
gjithnjë e më tepër drejt aktualitetit.

Që të pasqyrohet drejt dhe me forcë artistike ky ak-
tualitet, dihet që duhen kapur aspektet më tipike, të
cilat të trajtohen sa më afër realitetit tonë dhe caqeve
të konceptimit fëminor.

Por, që tema aktuale, me përmbajtjen e saj the-
llësisht revolucionare, ta luajë plotësisht rolin e saj li-
dhur me formimin e botëkuptimit materialist të brezit
tonë të ri, mendoj se në qendër të veprave tona duhet
të jetë njeriu ynë, kryesisht fëmija i ditëve tona.

Shpesh vihet re që u këndohet ose pasqyrohen shfa-
qjet e jashtëme të fenomeneve, ndryshimeve, trans-
formimeve dhe harrohet të vendoset në qendër të tyre
njeriu, shembulli i tij pozitiv, roli i tij krijonjës në
këto aspekte të jetës sonë.

Trajtimi i suksesëshëm i temës aktuale, kapja e më
pozitives, e më esenciales, e pasqyrimi i saj në letërsi, ja-
në të lidhura ngushtë me pozicionin që mban shkrimtari
ndaj realitetit objektiv.

Në është se ne do të shkrihem me këtë realitet,
do të gërmojmë, do të kërkojmë tipiken, atëhere në ve-
prat tona do të ketë jetë dhe forcë bindëse. Por në
goftë se ne do të mbajmë qëndrim soditës, atëhere nuk
do të mundemi të kapim dot shfaqjet e shembujt më si-
njifikativë dhe do të kërkojmë t'i gjejmë ato shembuj në
botën e kafshëve, në një mënyrë artificiale dhe anakro-
nike të të konceptuarit artistik. Kështu, p.sh., do të na
ndodhë që një vajzë e vogël, duke parë dallëndyshen
që ndërton follenë, mahnitet dhe emocionohet aq shumë
sa që të deklarojë: «Edhe unë, o babi im / si dallëndyshja
punëtorë / do të bëhem muratore / (B. Rama), ose do t'u
them fëmijëve të bëhen punëtorë si blëta apo të gu-

ximshëm si kjo e ajo kafshë duke harruar shembullin
e njeriut. Kësi shembujsh hasen shpesh; nuk është rasti
këtu për të numëruar shembujt, por për të evituar traj-
time të tilla të temës aktuale ku harrohet tipikja, esen-
cialja, pozitivja e vërtetë.

Një rol po kaq të rëndësishëm në trajtimin e temës
aktuale luan edhe këndi i vështrimit të shkrimtarit.
Shpesh vihet re një kënd vështrimi i ngushtë, individual,
i cili nuk arrin të hapet në plan të gjërë shoqëror. Në
veprat tona rëndom fëmija flet e vepron i vetëm, më
rrallë me njerëzit e rrethit familjar edhe akoma më rra-
llë në kolektiv.

Këndi i gjërë i vështrimit u jep veprave diapazon të
gjërë tematik, frymëmarrje, i largon nga çikërimat, nga
temat e vogla që lidhen pas një bote të ngushtë: nëna,
motra, gjyshja etj. Ndoshta këtu nuk duhet të merret
kallëp ndonjë mendim se kjo është bota më e madhe e
fëmijëve. Mendojmë se në këtë fazë të zhvillimit të përg-
jithshëm të shoqërisë sonë ky koncept është vjetëruar.
Ndoshta do të ishte më saktë ta quanim këtë bota më e
afërt, por jo më e madhja. Fëmijët mbi të gjitha duhet
ta kenë të qartë se në shoqërinë tonë mbizotëron kolekti-
vi dhe kjo është bota më e madhe dhe interesante e
të gjithëve.

Lidhur me trajtimin e temës aktuale dhe me objektin
kryesor të kësaj teme — njeriun — po përqëndrohemi
pak tek bota e tij (njeriut), në rastin konkret e fëmijëve
tanë. Për këtë çështje në raportin e shokut Bekim Çaçe
theksohet: «Kufizimi i tematikës vetëm tek bota e fëmi-
jëve në pjesën e saj dërmuese në krijimet për pionierë,
e ngushton mundësinë e njohjes e të edukimit». Kjo e
keqe (ngushtësia e mundësisë së njohjes e të edukimit)
nuk qëndron pikërisht këtu. Përkundrazi ne u jemi borxh-
linj fëmijëve në këtë drejtim — në trajtimin e botës
së tyre. Në veprat tona për fëmijë gjen më shumë gjy-
she e xhaxhallarë se sa vetë fëmijët. E keqja është se
ne akoma nuk po gjejmë mënyrën më të përshtatëshme
të lidhjes së natyrëshme të këtyre dy botëve, nuk po
arrijmë të pasqyrojmë botën e të rriturve në psikologji-
në e fëmijëve tanë.

Fëmijët tanë, sidomos pionierët, akoma nuk kanë një
vepër të gjatë në prozë ku të gjejnë jetën e tyre, veten
e tyre, problemet e konfliktet e shkollës, të organizatës,
të formimit të tyre të gjithanshëm, etj.

Edhe përsa i përket poezisë ajo mbetet poezi sipërfaqësore, deklamative, e përgjithëshme dhe pak përpjekje po bëhen për të dhënë detaje të reja, konkrete të realitetit ose për të hyrë në botën e brendëshme.

Ashtu si kërkohen kontradiktat e zhvillimit në letërsinë për të rritur, ashtu mund dhe duhet të kërkohen, sigurisht me përmasa të tjera, edhe në letërsinë për fëmijë. Nuk duhet harruar se edhe fëmijët kanë konfliktet e tyre, përpjekjet e tyre, ëndrrat e tyre, por ne i njohim pak ato dhe, ç'është e keqja, akoma bëjmë pak përpjekje për t'i njohur.

Mendoj se kjo kërkesë e drejtë e raportit duhet kuptuar si një kërkesë e domosdoshme e aktualitetit, pasi të kemi arritur të realizojmë me sukses pasqyrimin e botës së fëmijëve dhe të heroit fëmijë. Fëmija është fëmijë. Ai, në radhë të parë, kërkon veten e tij, botën e tij, ashtu siç kërkon i rrituri veten në letërsinë për të rritur.

Trajtimi i temës aktuale dhe përgjigja flakë për flakë ngjarjeve që kërkojnë pasqyrim të menjëhershëm është një nga detyrat që u shtrohen shkrimtarëve për fëmijë. Shkrimtarët kanë qenë të gatshëm t'u përgjigjen çështjeve të ditës. Por në këto raste ndoshta nga ngutja, ndoshta nga mungesa e njohjes apo nga mosprezumi artistik, ndonjëherë, autorëve u ka mbetur për t'u përgëzuar vetëm dëshira e mirë, kurse lexonjësit e vegjël e kanë pësuar si tek përralla e dhelprës dhe lejlekut: u është servitur gjella në një enë të papërshtatëshme dhe ata nuk kanë mundur ta shijojnë e ta gëlltisin dot. Kësisoj mund të përmenden ndonjë poemë për Shkurte Pal Vatën, për Ismet Sali Bruçajn, etj. Kërkesat e shkrirjes së formës në përmbajtjen dhe të njohjes së psikologjisë së fëmijëve janë kërkesa që, po nuk i respektove, lexonjësi i vogël me atë çiltërsinë e vet, nuk e ka për gjë ta flakë veprën tej apo ta lerë për një kohë të gjatë vitrinave të librarive, me gjithë etjen e tij të madhe për të lexuar.

Duhet pasur parasysh se letërsia për fëmijë ka specifikën e saj të veçantë të imponuar nga karakteristikat e moshës. Periudha e fëmijërisë është periudha më e gëzuar dhe pa preokupacione. Si e tillë ajo karakterizohet nga humori, nga shkathhtësia, nga çapkënllëqet etj. Por shpesh ne shkruajmë për fëmijët me atë seriozitet që shkruajmë për të rriturit. Në veprat tona, për fat të keq, hasim kryesisht fëmijë seriozë që mendojnë e ve-

projnë si të rritur, që nuk gabojnë kurrë dhe që, në fund të fundit, nuk janë njerëz të gjallë me të mira e me të meta, por skema.

Po i hoqe botës fëminore këto karakteristika i ke hequr atë që është esenciale, specifike e dallonjëse për të; ajo nuk është më botë fëminore dhe ata personazhe nuk mund të jenë më fëmijë.

Por, me sa vihet re, problemi i humorit nuk po merret seriozisht nga shkrimtarët për fëmijë, bile edhe kur ka pasur ndonjë tentativë të tillë, ndonjë kritik skeptik është munduar ta vlerësojë veprën apo personazhet si negativë, pa mundur të diferencojë negativën e vërtetë nga veprimi thjesht fëminor.

Trajtimi i temës aktuale nëpërmjet personazheve fëmijë, është njëra anë, besoj më e rëndësishmja, por duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me lexonjësin fëmijë, fantazia e të cilit i kapërcen caqet e realitetit, mund dhe duhet të kërkojmë forma të ndryshme trajtimi. Një fëmijë që lexon me kënaqësi «Artan Burizani dhe çeta e tij» lexon me po aq kënaqësi përrallën e vajzës që rendi pas bishtit të penës nëpër pyll e deri në fabrikën ku prodhohen penat (T. Shiroka), përrallën për lokomotivën e vogël (Gj. Vlasi), përrallën për lepujt që ndërtojnë parkun e lojrave (A. Zeka), apo për kafshët që ndërtojnë hidrocentral (T. Gjokutaj).

Jemi shumë larg kohës kur lexonjësvë të vegjël u servreshin përralla apo fabula të dobëta të ezauruara që në kohën e Ezopit. Sot nga fabula kërkohet një trajtim i ri, një moral i ri.

Konceptimi i qartë figurativ dhe shfrytëzimi racional i simbolit janë dy kërkesat bazë për të krijuar fabula të kapëshme dhe interesante. Populli dhe trashëgimia letrare u kanë atribuar kafshëve karakteristika specifike. Por në përrallën dhe fabulën tonë vihet re shpesh shfrytëzimi jo i drejtë i simbolit dhe shmangia në këtë drejtim nga tradita. Tentativat për të krijuar simbole të reja që nuk përputhen me karakteristikat reale, janë të pasuksesëshme dhe krijojnë imazhe e koncepte jo të drejta. Kështu kemi lepuj që ndërtojnë vepra dhe i mbrojnë ato me pushkë. Atëhere lind pyetja: për kë aludohet këtu? Po kështu kemi pata që hidhen përpara për të ndërtuar vepra. kur dihet kaq qartë natyra e ngathët e patës, sa në të folurit tonë ka hyrë si fjalë pexhorative. Ndryshe ndodh tek shkolla e pyllit (B. Dedja) apo «Do ndërtojmë hidrocentral» (T. Gjokutaj) ku, me ndonjë përjashtim të

vogël, simboli është shfrytëzuar drejt e, në disa momente, mund të themi bukur si tek kanarina mësuese e muzikës, tek palloi rrobapëpës (Shkolla e pyllit) ose tek dhitë që çojnë kazanet për të shkrire (Do ndërtojmë hidrocentral).

Trajtimi i temës aktuale, përmbajtja e re, kërkon edhe formë të re, konceptim të ri figurativ, fjalor të ri të ndikuar direkt nga tema. Kur flasim për formë të re nuk duhet kuptuar të shkruajmë për fëmijë me vargje të lirë, pa rimë ose pa ritëm, as të krijojmë figura të pakapëshme si fjala vjen «muzgu ngjyrë burbuqe», por nga ana tjetër as të përdoren forma të tilla anakronike «Rona rona peperona, po bie shi në arat tona».

Me gjithë sukseset e mëdha të arritura në periudhën midis dy plenumëve, ne akoma shkruajmë keq për fëmijët. Veprat tona për fëmijë në përgjithësi janë mjaft prolixë; zgjatemi e stërzgjatemi me paranteza e me digresione, me gjuhë e me dialogje të thatë e të dobët, me përshkrime të mërzitëshme e të panevojshme. Dhe raste të tilla gjen rëndom në botimet tona si në prozë edhe në poezi.

Sa më e thjeshtë, e qartë dhe sa më konçize të jetë vepra, aq më e këndëshme e më e dashur dhe më edukative është ajo për fëmijët. Të mos harrojmë se Tolstoi është i madh, por ai i ka shkruar aq shkurt e aq bukur tregimet për fëmijët.

NAUM PRIFTI:

Të gjallërojmë teatrin për fëmijë

Për disa vjet me radhë dramaturgjia për fëmijë bëri në vënd numro dhe ne, me një farë shkujdesje, u pajtuam me këtë gjendje. Ngjau diçka e veçantë pak nga pak, por në mënyrë të vazhdueshme: estrada dhe koncertet me recitime e këngë ua zunë vëndin shfaqjeve teatrale, i përzunë ato nga skena dhe aktiviteti teatral nëpër shkollat e nëpër shtëpitë e pionierit erdhi duke u pakësuar. Arësyet janë të shumta dhe justifikimet të ndryshme.

Është fakt historik se në lëvizjen artistike amatore e kryesisht të teatrit, peshën më të madhe e kanë mbajtur shkollat, sidomos shkollat e mesme dhe tetëvjeçare, si në periudhën para çlirimit ashtu edhe në vitet e para të çlirimit.

Të gjithëve na kujtohet se si në vitet e para të çlirimit ndërtonim skena të thjeshta nëpër oborret e shtëpive e qoshtet e rrugëve, me dy tre çarçafë që mezi ua shkullnim prindërve dhe luanim pjesë të ndryshme të degjuara ose të improvizuara ashtu si na dukej ne më mbarrë. Kjo lëvizje atëhere ishte si pasojë e influencës së fortë të teatrit partizan, të shfaqjeve teatrale që organizonin teatrot e brigadave e të batalioneve partizane. Reflektimi i kësaj influence ishte i gjithanshëm, ai gjente shprehje në tematikë, në mënyrën e vënies në skenë, në dekorin e thjeshtë, në lojën diletante. Shëmbëlltyra ish e qartë dhe teatrin partizan mund ta imitoje me lehtësi. Kjo ishte edhe një nga arësyet që ai u përhap aq tepër, bile edhe në fshatrat më të largët.

Ky teatër duke e gjykuar me syrin e sotshëm, kishte mungesa dhe boshllëqe artistike, por ai komunikonte me spektatorin në një mënyrë të natyrshme, së pari nga idetë që sillte në skenë, ide të reja në pajtim me kohën dhe nga mënyra thëllësisht popullore e lojës së aktorëve. Si spektatorët ashtu edhe aktorët kënaqeshin me pakë, sepse s'kishin rënë në kontakt me nivele të larta të lojës artistike, e cila filloi të duket në skenat tona si rezultat i ngritjes së trupave të teatrove profesioniste.

Le të jemi objektivë: nuk dua të pohoj se ngritja e teatrove profesioniste shoi lëvizjen amatore, por e vërteta është se solli një frenim, që sot mund të shikojmë si një grumbullim forcash për një hap të ri cilësor. Fakti është se lëvizja amatore e teatrit të shkollave dhe e të vegjëlve filloi të binte së pari në qytetet ku u ngritën teatrot profesioniste, si pasojë e konceptit të gabuar se tani kish një institucion të posaçëm, i cili ish i ngarkuar dhe mund të plotësonte atë ushqim të nevojshëm shpirtëror, edukimin ideoestetik që jep kjo degë e rëndësishme e artit. Po kështu dhe tradita e mirë e kremtimit të mbylljes së vitit shkollor me aktivitete artistike u la pasdore.

Kështu që mua më duket më i drejtë mendimi se pakësimi i veprave letrare në këtë gjini erdhi si pasojë se u pakësuan kërkesat për këtë fushë. Për këtë do të bindemi duke i hedhur një sy edhe grafikut të botimit të vëllimeve në këtë gjini.

Në se përmendëm lëvizjen amatore të fëmijëve pas lufte që ruante e kish frymë spontaneiteti, këtë nuk e themi për nivelin artistik, po për frymën popullore dhe masivizimin që kanë qenë faktorë shumë pozitivë.

Kërkesat e fëmijëve sot nuk janë më të pakta se ç'ishin atëhere. Ne të gjithë jemi dëshmitarë se me sa endje dhe me çfarë etje ndjekin fëmijët dy emisione të Radio Tiranës «Heroizmin e popullit në shekuj» dhe orën dramatike për të rriturit, që jepet çdo të mërkurë në mbrëmje. Ata rrijnë me veshin të mbërthyer pas radios dhe ndjekin me ankth peripecitë e heronjve. Tema e luftës dhe sidomos e Luftës nacional-çlirimtare, i tërheq në mënyrë të jashtëzakonshme. Ata kanë një dëshirë të pangopëshme dhe përpjnë me zell çdo episod të prindërve të tyre pjesëmarrës në luftë. Çdo partizan është në sytë e tyre një hero. Shpirti i tyre tërhiqet nga heroizmi dhe për këtë arsye si heronjtë e luftës, ashtu dhe heronjtë e sotëm janë kaq të dashur për ëndrrat dhe ndjenjat e tyre. Kjo është një fushë e gjërë për temat tona dramatike. Kësaj kërkesë të tyre të natyrshme ne nuk i jemi përgjegjur kurdoherë me seriozitet dhe ndjenjë përgjegjësie.

Në çdo vëllim të veprave të shokut Enver do të gjejmë materiale që kanë të bëjnë me organizatën e pionierëve dhe me probleme të veçanta të edukimit ideoestetik të fëmijëve, të cilat nisin që në ditët e para të çlirimit. Në krahasim me investimet e mëdha të fondeve dhe mjeteve materiale që ka vënë shteti në përdorim të fëmijëve, puna jonë si shkrimtarë është akoma relativisht e vogël.

Zhvillimi i vrullshëm i vendit tonë në të gjitha aspektet ekonomikë e kulturalë nxjerr në rend të ditës detyra të reja. Tani problemet e dramaturgjisë për fëmijë po diskutohen. Kërkesat janë shumë më të mëdha se ofertat dhe në vitet që do të vijnë kërkesat do të shtohen akoma më shumë. Tani nuk janë vetëm estradat dhe Radio Tirana ata që kërkojnë material skenik për fëmijët, por edhe teatrot profesioniste, kinostudioja «Shqipëria e Re», dhe, në një të afërme shumë të afërt, duhet menduar për operën e baletin dhe sidomos për emisionet televizive për fëmijë. Këto probleme do të bëhen të ditës dhe ne duhet t'u dalim përpara, me synimin e qartë që të gjejmë rrugët më të përshtatshme në mënyrë që të shtojmë prodhimtarinë duke ju përgjegjur kërkesave dhe të ngrehim në një shkallë më të lartë nivelin artistik.

Ne edhe sot, nga nevojat e ngutëshme për këtë letërsi, bëhemi dorëlëshuar duke u munduar ta justifikojmë veten me fraza «E po këta janë, s'kemi ç'bëjmë!» ose «Më mirë të kemi diçka se sa hiç fare!» Mirëpo pastaj pajtohemi padashur me nivelin jo të kënaqshëm të veprave duke i pranuar ato si një mesatare artistike. Nesër ka rrezik, të sntyrë nga kërkesat e mëdha, të tregohemi më pak ekzigjentë.

Në raportin e shokut Bekim Gaçe u prek dhe problemi i teatrit për të vegjël. Ideja për ngritjen e një teatri ka një sërë problemesh e vështirësish dhe do kohë. Ministria e Arësimit dhe e Kulturës u ka kërkuar teatrotve profesioniste që së paku një shfaqje në vit t'ua kushtojnë fëmijëve. Deri tani teatrot e Vlorës dhe të Shkodrës janë treguar të gatshëm duke vënë me sukses pjesën «Filizat» të Leka Bungos dhe «Pionieri» të Jovan Vujoshit. Teatrot e tjera janë në kërkim të pjesëve. Ka të ngjarë që edhe sivjet drejtë e teatrotve të justifikohen se nuk gjetin pjesë. Dhe ne sërish do të mbetemi atje ku ishim, shfaqje teatrale për fëmijë s'do të ketë.

Më duket se këtu ka një ngatërresë në konceptet. Mendohet sikur pjesa për fëmijë duhet të ketë me domosdo protagonistë dhe aktorë fëmijë, gjë që nuk është e drejtë. Por ne e kemi pranuar këtë si normë dhe tani teatrin për fëmijë nuk e mendojmë dot pa fëmijë. Pjesa «Flamur në stuhi» kushtuar Adem Rekës ose «Komunistja 15 vjeçare» kushtuar Shkurte Vatës fare bukur mund të numroeshin dhe të mbaheshin në repertor si çfaqje për fëmijë.

Edhe në letërsinë botërore ka plot vepra ku s'kemi të bëjmë me fëmijë dhe numërohen si vepra të kësaj letërsie, si «Udhëtimet e Guliiverit», «Robinson Kruzo» etj. Fakt është, se përrallat s'kanë fëmijë brënda, por i përkasin kësaj letërsie.

Nga ana tjetër, nuk duhet të harrojmë lëvizjen amatore të shkollave ose, si mund ta quajmë ndryshe, teatrin e të vegjëlve.

Në këtë lëvizje vihen re edhe shfaqje formalizmi, sidomos kur organizohen olimpiada. Atëhere grupet e shkollave shkojnë dhe konkurojnë para zhurisë, disa herë pa dhënë asnjë shfaqje para nxënësve të shkollës së tyre. Kështu olimpiadat e shkollave të mesme kthehen në qëllim në vetvete. Ato sjellin çmime dhe fletëlavdërime, por jo aktivitete artistike me jetë të gjatë.

Gjendja e tanishme e letërsisë dramaturgjike nuk është e shkëlqyer, por pjesët e mira nuk mungojnë si

«Bijtë e punëtorëve» e Musa Vyshkës, «Tani vijë sho-kët» e Adelina Mamaqit, pjesët me një akt të Kolë Jakovës, Ilija Dedit, të Ramadan Pasmaxhiut, Gaqo Bushakës e të ndonjë tjetri.

Pozitive është prirja e përgjithëshme për të trajtuar temën e luftës dhe temën aktuale në një linjë realiste dhe të shëndoshë. Sot kjo prirje po zotëron mbi përrallën me simbole dhe kafshë me temën e përjetëshme të fitimit të së mirës mbi të keqen.

Të metat që vihen re më tepër në dramaturgjinë për fëmijë janë nga njëra anë njohja e paktë e botës së fëmijëve dhe, nga ana tjetër, njohja e paktë e kërkesave specifike të këtij teatri.

Autorët për fëmijë, pa qenë mësues dhe psikologë, duhet t'i njohin këto disiplina. Kërkesat psikopedagogjike kanë të bëjnë si me adresimin e saktë të veprës ashtu dhe me transformimin e personazhit fëmijë në një veprë letrare. Disa aktorë i quajnë fëmijët më pakë të zgjuar nga ç'janë, qëkurse i venë të flasin aq thatë. Ne themi se bota e fëmijëve është e madhe dhe këtë e pranojmë si një aksiomë, por më shumë i bëjmë thirrje kujtesës sonë, duke rënë në mëshirën e saj, se sa përpiqemi të hyjmë me të gjitha forcat në këtë botë.

Dramaturgjia për fëmijë ka nevojë për heronj frymëzues me pasione të larta, me ideale komuniste. Ky hero do të gjente miratim në zemrat dhe në ndjenjat e tyre. Këta heronj e luftëtarë në brigadat e punëtorëve, në kantieret e fushat e atdheut janë kudo në jetën tonë, janë prodhim i kësaj toke.

Veçantia tjetër është se në dramaturgjinë për të vegjël duhet të mbizotërojë konkretja mbi abstrakten. Linja e veprimit të jetë e qartë dhe e pasur me aksione. Disa herë autorët pa përvojë i mbushin veprat me moralizime, sepse këto u duken si më të lehta për fëmijët, ndërkohë që këto janë më të vështira për ta, sepse edhe moralizimet janë abstraksione të një ideje.

Viti 1971 nisi i mbarë, me premierë në teatrin e kukllave në Tiranë, me filmin «Guximtarët» dhe me tre takime zonale të estradave profesioniste në Shkodër, Pogradec dhe Sarandë që u zhvilluan prej datës 15 janar e deri më 3 shkurt. Këto takime qenë një rast i bukur për të shkëmbyer dhe për të përgjithësuar eksperiencën e mirë, si edhe për të përcaktuar në mënyrë më shkencore rrugën më të përshtatëshme për përfundime sa më të mira në edukimin e brezit të ri me normat e moralit komunist.

KOLË JAKOVA:

Aktualiteti dhe përralla

Në referat, me të drejtë, ju dha shumë rëndësi ngri-tjes artistike. Në këtë drejtim letërsia për fëmijë është akoma mjaft borxhlije ndaj të vegjëlve. Ngrija e nivelit artistik ka të bëjë, përveç talentit, kryesisht me njohjen e jetës së fëmijëve. Jeta sot ecën shpejt. Kjo ndikon pa-tjetër në jetën e fëmijëve, në njohuritë dhe përgjithë-sisht në shpirtin e tyre. Fëmijët janë fëmijë, siç ishim edhe ne dikur. Por ne e kaluam fëmijninë ndryshe nga ç'e kalojnë fëmijët tanë. Pra, duhen njohë dëshirat dhe kërkesat e fëmijëve sot. Ndryshe vepra me përmbajtje aktuale e ka të vështirë të tingëllojë në shpirtin e tyre. Nuk duhet të vemë në bazën e krijimeve tona fëmij-ninë tonë të dikurshme me ato kërkesa dhe ato dëshira. Fëmijët tanë rriten ndryshe. Botëkuptimi i tyre është xhveshë shumë nga paragjykimet dhe një sërë mbetu-rinash të botës së vjetër dhe është pajisur e brumosë me gjëra të reja, njohuri të reja dhe ambient të ri. Por prapë ata janë fëmijë, kanë ndjenja, kanë fantazi. Pikë-rihet letërsia e përshtatëshme me kërkesat e reja i rrit ata të shëndetshëm shpirtërisht dhe i hap horizonte fan-tazisë së tyre. Një letërsi e dobët artistikisht dhe e shtre-mbët ideologjikisht e dëmton rëndë. më rëndë se të madhin.

Fëmijët tanë janë të etur për letërsi të mirë. Duhet dijtë se veç letërsisë së pakët që i japim ne me anë të librit të shkollës, radios, etj., fëmija merr përditë letërsi gojore. Atë e merr me anën e gjyshërve, gjysheve, baba-larëve dhe nënave. Kjo letërsi gojore në përgjithësi ka vullë të botëkuptimit të vjetër. Njëpërmjet të kësaj letër-sie depërton e vjetra tek fëmijët tanë. Fëmijët kërkojnë me ngulm përralla. Dhe prindët e të afërmit u tregojnë fëmijëve përralla me mbret. Jo rrallë ky mbret është i mirë dhe për t'u mëshëruar se vuan. Në këto përralla hyn shpesh edhe mitologjia e popullit tonë me mbetu-rinat fetare ilire si dhe fetë e ndryshme. Hyjnë pra shtriga e shtojzovalle, lugetër që ngrihen natën nga varri, shënjtore që bëjnë mrekullira, baballarë me mje-kër që fluturojnë natën etj. etj. Këto lloj përralla nuk tregohen vetëm në fshat e malësi, por edhe në qytete. Kur ja mbarova së treguari një fëmije gjashtë vjeç një

përrallë me kafshë, u çudita kur më tha: «Xhaxhi, mua më pëlqejnë shumë përrallat me shtriga. Din ti ndonjë të tillë?» E pra fëmija kish një familje të ngritur. U interesova të di se nga i kishte dëgjuar fëmija përrallat me shtriga dhe dilte se asaj ja kishin treguar gjyshet, halla plakë etj., etj. Pra problemi nuk është aq i thjeshtë. Duhet një punë e madhe për ta shkëputë fëmijën tonë nga ndikimet e botës së vjetër. Kjo detyrë i bie, në radhë të parë, letërsisë së re për fëmijë, letërsisë me botëkuptim të ri socialist dhe me ngritje artistike.

Një rëndësi të veçantë tashti merr përralla. Në përrallën tonë popullore në përgjithësi ka botëkuptim të shtrembët dhe mitologji. Njëkohësisht ajo ka edhe formë nacionale. Për kushtet historike të popullit tonë këto të gjitha kanë ecë së bashku. Mbretërit, shtrigat, lugetrit, të mburjtur me botëkuptim të vjetër antishkenkor dhe prapanik, kanë udhëtuar së bashku me formën nacionale të përrallës sonë. Një përmbajtje e tillë përrallash bie në kundërshtim flagrant me atyrimin shpirtëror të fëmijëve sot. T'u flasësh sot atyre për shtriga e lugetër do të thotë të çakërdisësh mendjen e tyre të njomë dhe të formosh tek ata pikëpamje të shtrembëra për jetën.

Por në popull ka dhe përralla të pastra, plot realizëm dhe moral që vlen edhe sot për fëmijët tanë. Zëdhja me kujdes e këtvre përrallave, pastrimi i të tjerave, që kanë mundësi të pastrohen nga morali i vjetër dhe reaksionar, do të ishte një kontribut dhe një orientim i mirë për ata që duan të lëvrojnë përrallën. Jo vetëm kaq, shkrimtarët mund të krijojnë përralla duke u bazuar drejt në përrallën popullore. Me përralla të tilla të vegjëlit vihen në korant me të kaluarën e popullit tonë për të cilën tregojnë aq dëshirë. Kjo e kaluar patjetër jepet e pastruar nga mitet, fantazitë e tepëruara, jepet më reale dhe më e kuptueshme për të vegjëlit. Kjo lloj përralle ka një të mirë, se ruan formën nacionale, e cila ka vetinë që ta bëjë më të kuptueshme dhe më tërheqëse përmbajtjen. Forma nacionale duhet të ndihmojë jo vetëm përrallën, por të gjithë letërsinë për të vegjëlit.

Por fëmijët kanë nevojë për përrallën e re në kuptimin e mirëfillët të fjalës, përrallën që trajton kohën e re, kohën në të cilën jeton vetë fëmija. Në këtë drejtim kemi pasë disa suksese dhe shpresat janë të mira. Duke e mburjtur formën nacionale me përmbajtje të re socialiste, përrallat e reja u kanë dhënë fëmijëve njo-

huri të sakta dhe tërheqëse për jetën dhe revolucionin që zhvillohet në vëndin tonë. Por në këtë drejtim mendoj se jemi në hapat e para. Përralla e re kërkon zhvillim të madh. Këtë detyrë ja vë sot koha.

PANDORA DEDJA:

Të përpunojmë teorinë dhe kritikën e përrallës socialiste

Vitet e fundit letërsia jonë për fëmijë ka patur suksese edhe në lëmin e krijimit të përrallës së re. Bile mund të thuhet me plot gojën se kjo gjini është shquar për një cilësi të lartë artistike tek krijimet më të mira. Të këtuilla kanë qenë përrallat e bukura «Stika» e «Pika e ujit» të Naum Priftit, «Sopata dhe lisi plak» e përralla të tjera të Bekim Gaçes, «Vinxhi mëndjemadh» dhe «Rubineti qaraman» të Gjergj Vlashit, «Do ndërtoj më hidrocentral» e Tasim Gjokutës, «Pylli oshëtin» e Fotaq Malos etj. etj. Pavarësisht nga vërejtje të pjesëshme, këto lloj përrallash kanë fituar admirimin e masës së lexuesve të vegjël, të edukatorëve të kopshteve dhe të prindërve. Madje, nuk do të ishte keq që, me ripunime e përmirësime, këto përralla të ribotoheshin herëpas-herë, mbasi për çdo vit ka kërkesa për të nga ana e lexuesve të vegjël, që vinë sërë-sërë.

Po që përralla jonë socialiste, të shkojë përpara është shumë e domosdoshme që kritika jonë letrare të ndihmojë procesin e zhvillimit të saj, duke vënë theksin në tendencat e reja, në tiparet, që e dallojnë atë nga përralla tradicionale, goftë në pikëpamje të përmbajtjes, goftë në pikëpamje të formës, duke vënë në dukje elementet e saj të domosdoshëm për t'ua përshtatur më mirë veçorive psikike që kanë fëmijët e sotëm. Pra, kuptohet se si për çdo lloj letrar të shkrimeve për fëmijë, edhe për përrallën duhet të organizojmë përpunimin e mendimit tonë teorik dhe kritik dhe jo t'ia lëmë këtë spontaneitetit.

Në këtë mënyrë ne do t'i ndihmonim shumë autorët tanë, veçanërisht të rinjtë, që të shpëtojnë nga mjaft të meta tipike, që gjejnë çfaqje në ndikimin nga përralla tradicionale.

Si shprehen këto të meta tipike?

Së pari, në drejtim të përdorimit jo kritik të elementëve, formës dhe mjeteve artistike të përrallës së vjetër, dhe, së dyti, në krijimin e së resë artificiale dhe të sipërfaqëshme. Prandaj problemi themelor në këtë mes është **qëndrimi, që duhet të mbajmë ndaj përmbajtjes, formës dhe mjeteve artistike të përrallës së re socialiste.** Ngandonjëherë në përrallat tona thjeshtësohet jashtë mase përmbajtja e përrallës dhe autori shkruan, sikur ka përpara lexuesin e vogël, që besonte çdo «mrekulli», si ato të Lizës së dikurshme në botën e çudirave. Sigurisht, bota e sotme e fëmijëve tanë është shumë më e pasur se ajo e fëminisë sonë. Përftyrimet e tyre materialiste krijohen më shpejt, prandaj kërkesa themelore e përrallës së re duhet të jetë synimi për të formuar këtë botëkuptim.

Mjetet artistike, si animizimi etj, janë të pranueshëm dhe të domosdoshëm te përralla, se i vogli e kërkon çdo gjë për rreth në lëvizje, në gjallëri të plotë; po shumë herë me animizimin e sendeve arrihet në tëpërime të tilla sa që fletorja e arithmetikës — personazh, arrin ta bindë nxënësen e shkollës që të bëhet e kujdesëshme dhe të mos e harrojë kurrë fletoren e detyrave në shtëpi. Në përrallën «Kush është fajtori të Tasim Gjokutës botuar në «Fatosi» Nr. 9, 1970» autori fut në marrëdhënie dhe në biseda për të gjetur fajtorin teze Letën, Benin, Topin dhe njollat e bojës në mur. Edhe këtu topi me njollat e bojës janë animizuar me të drejta të barabarta si teze Leta dhe Beni. Po kështu e njëjta gjë vihet re edhe në përrallën e Llambro Rucit «Dritani dhe lajmëtari këmbëshpejtë», botuar në Nr. 10 të revistës «Fatosi» dhe në mjaft përralla të tjera. Siç dihet, në këto raste kemi animizimin, si në përrallat e vjetra, ku nuk merret parasysh pjekuria e herëshme e lexuesve tanë të vegjël.

Po ka edhe raste kur përmbajtja e përrallës varfërohet shumë dhe këtu nxjerr kokën tradita e përrallës së vjetër. Tek «Poku Çamaroku» i Loredan Bubanit kemi një ari të vogël, i cili po të largohet nga prehëri i nënës bëhet mosmirënjohës e frikacak që i trembet errësirës së pyllit etj. dhe që përsoset nga pikëpamja e sjelljes sa po kthehet në gjirin e nënës.

Shumë bukur zgjidhet problemi i përmbajtjes dhe mjeteve artistike të përrallës së re, p.sh., te «Stika» e Naum Priftit që duhet konsideruar ndër krijimet më të bukura në këtë gjini. Konvencioni që ka zgjedhur autori në këtë përrallë ka si bazë dhënie e njohurive shkencore mbi transformimin e farës së pishës. Idetë e thjeshta të përrallës kanë marrë ngjyra të natyrshme dhe të hijshme nëpërmjet fabulës së Stikës, që joshet nga ketri, tërhiqet në strofkullën e nëndheshme të uritit dhe përfundon pastaj në pranverë në një filiz të ri pishë. Sigurisht që fëmija e beson këtë natyrshmëri fantastike. Megjithatë autorit mund t'i bëhej ndonjë vërejtje për këtë përrallë, pasi duket si i tepërt ai sentimentalizëm i vjetër i iriqit për martesën e mbesës. Ky është një element i huaj për përrallën e lexuesve fare të vegjël.

Të njëjtat fjalë të mira mund të themi edhe për përrallën «Pika e ujit», ku subjekti është pak a shumë i kësaj natyre. Te «Sopata dhe lisi plak» i B. Gaçes është sintetizuar bukur ideja e madhe e kohës sonë, se kur i vogli ka të drejtën pas, e mund të madhin.

Në përralla, qofshin këto për botën e kafshëve, ose të teknikës dhe shkencës, gjen pasqyrim e reja, revolucionarja. Fëmija, nëpërmjet kësaj gjinie njihet me ndryshimet e mëdha që po ndodhin në shoqërinë tonë socialiste. Kështu, p.sh., te përralla «Vinxhi mëndjemadh» të Gjergj Vlashit del në pah bukur ideja që grua-ja sot ze një vend të rëndësishëm në shoqëri dhe dënohet pikëpamja për paaftësinë e saj. Po kështu mund të flisnim edhe për përrallën e Aristotel Micit «Lepurushi dhe qetë» botuar në revistën «Fatosi» Nr. 2, 1970 që pasqyron mirë ndryshimet që po ndodhin në fshatin tonë socialist.

Te përralla në vargje «Do ndërtojmë hidrocentral» të T. Gjokutës, pa rënë në skema sociologjike, pasqyrohen drejt dhe me fantazi elementet socialiste të jetës sonë. Duke vënë ujkun dhe dhelpren përballë kolektivit të kafshëve, që punojnë për dritën, në mënyrë elementare autori i njuh fëmijët me luftën e klasave.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për «Shkollën e pyllit» të B. Dedes, ku duke përmendur se bashkë me kafshët e tjera i çojnë fëmijët në shkollë edhe ujku i çalë me dhelpren plakë, të vegjëlve u shtihet në mend se aty diku, midis nesh fshihet dhe e keqja, të cilën duhet ta bëjmë të njohur.

Pra, problemi i fantastikes, i përshtatjes së saj me moshën dhe eksperiencën e fëmijëve është një problem parimor për përrallën e re. Me fantastikën në përrallë ne kuptojmë aftësinë e autorit për të krijuar konvencione, përfytyrime dhe figura, që themelet i kanë në realitetin objektiv, por që dallohen nga ky realitet në përputhje me kërkesat e moshës së fëmijëve për t'i animuar sendet dhe fenomenet. Në rast se kjo masë e dallimit midis fantastikes dhe reales e ruan ekuilibrin në përrallë dhe, në tërësi, mbështetet në shtratin e moralit komunist dhe idealet e jetës sonë, atëherë një përrallë e tillë pa asnjë dyshim i shërben edukimit komunist të brezit të ri.

Duke shtruar këtë mendim, nuk mund të mos polemizosh gjer në një farë shkalle me pikëpamjen kontraktore të Gjergj Vlshit të shprehur në artikullin «Përralla në letërsinë tonë për fëmijë» botuar në «Nëndori» (Nr. 11, 1970). Ai, nga njera anë pranon se, sidomos përralla e re ka gjëra të përbashkëta me letërsinë fantastiko-shkencore, po nga ana tjetër, shpreh keqardhjen se shkrimja e tyre mund të sjellë zhdukjen e përrallës, gjë që nuk qenka as e dobishme dhe as e drejtë!

Në qoftë se ne arrijmë ta mbështesim masën dhe raportin midis fantastikes dhe reales jo vetëm mbi themelin e realitetit socialist dhe të moralit komunist, po edhe në përparimin shkencor dhe teknik, që po realizohet në vendin tonë dhe në botë, ne nuk kemi asnjë humbje, jo vetëm për edukimin e fëmijëve dhe zhvillimin e shëndetshëm psikik, po as për humbjen e përrallës si gjini.

Jeta objektive dhe realiteti socialist bëjnë të tyren shoqëria jonë ecën përpara, shkënca gjithmje e më shumë do të bëhet pjesë e pandarë e jetës sonë të përditëshme, prandaj edhe përralla patjetër do të evoluojë dhe më, do të evoluojë vazhdimisht si përmbajtje dhe si formë, do të bëhet, si të thuash, më shkencore, duke pasqyruar zhvillimin e realitetit objektiv, do t'u flasë fëmijëve më me kompetencë, në përshtatje me moshën, me gjuhën e realizimeve shkencore dhe teknike. Prandaj këtu, veç fitimit, ne nuk do të kemi asnjë humbje, sepse do t'u vijë fundi njëherë e mirë «mjeteve çuditërisë ireale».

STAVRI KRISTO:

Letërsia jonë për fëmijë - letërsi e shëndoshë

Letërsia jonë për fëmijë është një letërsi e shëndoshë, sepse ajo pasqyron një jetë socialiste të shëndoshë arkitekte e së cilës është PPSH. Ajo po zhvillohet vazhdimisht, sepse udhëhiqet nga Partia dhe sepse për të kujdeset personalisht shoku Enver Hoxha.

Në raport u vunë në dukje mirë sukseset e kësaj letërsie në zhvillim. Megjithatë, si punonjës i redaksisë së letërsisë për fëmijë e të rinj në Shtëpinë Botuese «N. Frashëri», nga kalojnë për herë të parë krijimet letrare, kur dëgjova numurin e librave dhe autorëve që u përmendën në raport, më pushtoi mendimi se edhe me letërsinë për fëmijë ndodh ajo që ndodh me të gjithë zhvillimin tonë socialist: ritmet e zhvillimit dalin shpejt nga kufitë e statistikës.

Do të sjell një shembull:

Shoku Bekim foli për librat e botuara dhe tha se gjatë 10 vjetëve të fundit kanë dalë 150 tituj. E, pra, vetëm gjatë vitit 1970 redaksia jonë ka dërguar në shtyp 73 tituj (që s'janë llogaritur në raport); 42 prej këtyrë botimeve të reja i përkasin letërsisë artistike origjinale; 24 prej tyre janë vëllime me vjersha e tregime të shkrimtarëve e letrarëve që dalin për herë të parë përpara lexuesve të vegjël. 24 firma të reja brenda një viti. 24 letrarë të tjerë e kanë parë botën nga këndi i vështrimit të fëmijëve, të nisur nga dëshira që me penën e tyre të farkëtojnë karaktere luftëtarësh komunistë, të nisur nga dëshira që idealet e larta estetike të kohës t'i shndërrojnë në parime etike në jetën e fëmijëve.

Skënder Hasko, Leonidha Mërtiri, Dodona Hoxha, Andon Lula, Myzejen Kalaja, Astrit Bishqemi dhe Skënder Tapija janë vetëm 7 emra të rinj nga këta 24 që i shtohen vargut të autorëve, që përmendi në raportin e tij shoku Bekim.

Në raport u vu në dukje, me të drejtë, se një kusht i domosdoshëm për zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë për fëmijë është njohja më e thellë e botës së brendshme dhe e psikologjisë së fëmijëve, që ka të

bëjë me adresimin më të saktë të krijimtarisë letrare, duke pasur si bazë moshën dhe specifikat e saj. Rreth këtyre çështjeve desha të thosha edhe unë dy fjalë, se janë pikërisht këto që e përcaktojnë fytyrën e kësaj letërsie.

Po nuk i pati parasysh pikërisht këto veçanti të moshave, shkrimtari s'krijon dot për fëmijë vepra me vlera ideoartistike, sepse s'ka libër që t'u adresohet të gjitha moshave. Edhe libri më i mirë, i shkruar për pionierin 12-vjeçar, fjala vjen, nuk do të jetë aspak tërheqës për fëmijët e moshës parashkollore, ndofta edhe për nxënësit e klasave të para. Se edhe libri që mund t'i lerë mbresa për gjithë jetën një fatosi, s'do t'i bënte asnjë përshtypje atij sikur ta lexonte pas shtatë-tetë vjetësh, kur të ishte në klasën e gjashtë...

E, me që është kështu, me që edhe specifika për fëmijë ka nëndarjet e saj dhe është e pamundur të flasësh për letërsinë për fëmijë si për një të tërë të përndarë, do të them dy fjalë për ndonjë problem, veçanti dhe për ndonjë vepër që ka të bëjë me moshat e vogla 3-6 vjeç.

Po e them që në fillim se jam në një mendje me shokun Bekim, se ndarja e tanishme e letërsisë për fëmijë në tri biblioteka, në të «Fatosit», «Pionierit» dhe «Rinisë», është një ndarje e gjerë. Midis parashkollarëve 3-6 vjeçarë dhe nxënësve të klasave të ulta të shkollës fillore, të cilëve ju adresojmë librat e bibliotekës «Fatosi» ka ndryshime të mëdha me karakter psikologjik, ka dallime interesash, të cilat kur merren parasysh nga shkrimtari e shtojnë shumë ndikimin edukativ të veprës të lexuesi dhe kur s'njihen ose s'merren parasysh, shkojnë ndesh me atë botë e psikologji, pra, s'kontribuojnë (për të mos thënë se dëmtojnë) në edukimin e fëmijëve. Duke botuar, pra, librat e të dy moshave në një «bibliotekë» në atë të «Fatosit», pa një nëndarje dhe specifikim më të saktë, ne jo vetëm që nuk i lehtësojmë prindërit dhe edukatorët në zgjedhjen e librave për fëmijët e tyre, (një çështje «teknike» jo pa rëndësi kjo) por nuk u ndihmojmë edhe shkrimtarëve të rinj, sepse krijojmë tek ata përshtypjen se midis këtyre dy moshave s'ka dallim e veçanti, gabim për të cilin paguajmë haraç pastaj, se marrim prej tyre vepra pa adresë të saktë, të përgjithëshme, vëllime në të cilët nganjëherë gjen poezi dhe tregime për parashkollarët dhe për fatosat më të rritur, për pionierët dhe për të rinjtë...

Ngatërrojmë kështu ndonjëherë (një shaka të vogël)

edhe ndonjë nga kritikët, i cili duke mos dalluar veçantitë e moshave, duke i parë vjershat për fatosat e kopshteve me syrin e letërsisë për pionierë, zbulojnë në vepër «budallallëqe të tilla», fjala vjen, që «s'pajtohen fare me realitetin objektiv», si këto: Hipin njerëzit dhe kafshët së bashku në një tren, kur dihet prej të gjithëve se atje ka vagon të veçantë edhe për mallrat, kur dihet prej të gjithëve se rregulloret s'të lenë të futësh as gjelin e detit në autobus, në prag të vitit të ri; ose te «Artan Borizani dhe çeta e tij» ku mblihdhen të vendosin kontroll punëtor... Ç'absurditet (për kritikën)! Si mund ta bëjnë këtë kalamanët e kopshteve?...

Nejse, shakaja shaka, por duhen ndarë më mirë shkrimet, sipas moshave, dhe sigurisht, duhen kuptuar më mirë dhe më thellë edhe nga kritika veçantitë psikologjike të fëmijëve të çdo moshe.

Le të kthehemi tani te mosha 3-6 vjeç.

Në këtë moshë, si gjatë gjithë periudhës së rritjes, fëmija mëson e përgatitet për në jetë duke imituar të rriturit. Dhe veprimtarinë e të rriturit fëmija e kësaj moshe e imiton në lojë dhe nëpërmjet lojës. Në këtë moshë fëmija «nget» traktorin dhe maqinën; një copë tullë, një spango me një kuti konserve bëhet makinë me rimorkjo që vete shkarkon tulla në hidrocentral: një copë shkop bëhet kalë me fletë, të cilit i hipën fëmija dhe pret e grin turqit dhe gjermanët (ani pse në kohën e Skënderbeut s'kish gjermanë në Shqipëri); shkopit bëhet një herë tjetër pushkë me bajonetë, ving...

Është, veç të tjerave, pikërisht njohtja e thellë e veçantive psikologjike të moshave, aftësia për ta përdorur këtë veçanti në krijimtarinë letrare që i siguron shkrimtarit Bedri Dedja dashurinë e lexuesve të vegjël dhe mirënjohjen e prindërve që e kuptojnë se ai e fut fantazinë e ndezur të fëmijëve në shtratin e problemeve më të rëndësishme të kohës.

Është pikërisht fryt i një kuptimi të tillë të veçantive psikologjike të moshës që i ka dhënë dorë edhe Odhise Grillo në shumicën e vjershave të vëllimit të tij të fundit «Këngë në kopsht» që në lojë e nëpërmjet lojës t'i verë me natyrshmërinë më të madhe katërvjeçarët të hapin taraca që të bëhet gruri det dhe të ndërtojnë hidrocentralin që t'i çojnë malësisë dritën e partisë. Është ky vështrim i botës së madhe të të rriturve me syrin e katërvjeçarëve që ju rrit vjershave forcën ideomocionale, ashtu siç është, me siguri, mosthëllimi në këto çështje, që bëhet shkas për të ulur këto vlera në

vjershat «Kazmat lart i ngrini, pushkët lart i mbani», «Të urojmë gjithë sot...» dhe në ndonjë tjetër ku shfaqen më shumë dëshirat e të rriturve, dëshirat e babajt, për ta parë nesër të bijën heroinë si Nora dhe si Shkurte Vata, punëtore dhe doktoreshë, që kufizojnë ndikimin ideocemocional të fjalës artistike tek të vegjëlit...

Vjershat e mbushura me «nesra» tentojnë t'i shkëputin më kot fëmijët nga bota e tyre plot fantazi të ndezur, ku ata «janë» edhe punëtorë edhe kooperativistë, edhe doktorë, (vizitojnë, bile, edhe të sëmurë) edhe inxhinierë (ndërtojnë, bile, edhe hidrocentrale).

Pse, pra, ta largojmë fëmijën nga kjo botë në veprat tona letrare?

Por duke folur për njohjen e veçantive psikologjike të kësaj moshe të mos krijohet përshtypja se me këtë mbaron gjithshka. Jo, do njohur mirë edhe bota e madhe e të rriturve, që e futim, nëpërmjet shkrimeve, në botën e fëmijëve, në mënyrë që t'u japim atyre njohuri të sakta për jetën. Kjo çështje shikohet cekët nga disa letrarë të rinj, veçanërisht, kur ata futin në krijimet për fëmijë gurë e drurë, ari dhe bletë. Do të sjell një shembull nga vëllimi me vjersha të bukura i letrarit të ri Lliko Nano për të treguar se sa e nevojshme është njohja e jetës. Në vjershën «Një shtyllë elektrike» të vëllimit «Vala kaltëroshe», «ka një pasaktësi të vogël. Pikërisht atje ku duhej të mbaronte vjersha, ai e zgjat me dy strofa, dhe shton se nga degët e bredhit që u bë shtyllë (merret me mend se sa të trasha janë ato) bëhen dërrasa. Po më shumë të bie në sy kjo të «Bletët dhe ariu zemërkeq». Kur ariu zemërkeq sulmon bletët, është mbretëresha-mëmë që vërsulet e para kundër tij. Në të vërtetë s'ndodh kështu. Bleta, mëmë s'thumbon armiqtë dhe nuk u shfaqet atyre. Po një pasaktësi tjetër është më e rëndësishme. Bletët edhe miqtë pasi «e cimbin arinë sa e shembën në tokë, vazhduan gostinë. E para, bletët nuk cimbin (siç thuhet në vjershë), por thumbojnë dhe pasi thumbojnë vdesin, siç thotë populli për ta nderuar atë që i ngjan aq shumë shqiptarit: vdes për të mbrojtur lirinë.

Le të mos mendohet se me që fantazia e fëmijëve të kësaj moshe është e ndezur, mund t'u japim atyre edhe njohuri të pasakta. Dhe kjo, më duket është po kaq e dëmshme sa e shembën në tokë, vazhduan gostinë. E para, bletët nuk cimbin (siç thuhet në vjershë), por thumbojnë dhe pasi thumbojnë vdesin, siç thotë populli për ta nderuar atë që i ngjan aq shumë shqiptarit: vdes për të mbrojtur lirinë.

Le të mos mendohet se me që fantazia e fëmijëve të kësaj moshe është e ndezur, mund t'u japim atyre edhe njohuri të pasakta. Dhe kjo, më duket është po kaq e dëmshme sa e shembën në tokë, vazhduan gostinë. E para, bletët nuk cimbin (siç thuhet në vjershë), por thumbojnë dhe pasi thumbojnë vdesin, siç thotë populli për ta nderuar atë që i ngjan aq shumë shqiptarit: vdes për të mbrojtur lirinë.

zani, kur dinë të ndërtojnë hidrocentrale, të zhdukin mbeturinat e së kaluarës, të vendosin, bile, edhe kontrollin punëtor njësoj si të rriturit, si «Artan Borizani me çetën e tij»?

BEKIM HARXHI:

Fryma revolucionare në letërsinë tonë për fëmijë

Duhet pohuar me kënaqësi se edhe letërsia jonë e re për fëmijë, duke ecur në traditat më të mira demokratike e patriotike, është futur në përgjithësi, e shëndoshë dhe e sigurtë, në gjërsi dhe thellësi, në rruqën e realizmit socialist, duke u bërë kështu, gjithmonë e më mirë, një mbështetje e shëndoshë e Partisë për edukimin komunist të brezit të ri e, në veçanti, për edukimin ideopolitik të tij.

Por stadi i arritur në zhvillimin e përgjithshëm të jetës sonë dhe sidomos thellimi i revolucionit ideologjik, kërkojnë një zhvillim të mëtejshëm edhe të letërsisë sonë për fëmijë, i diktojnë asaj, si mjet i fuqishëm edukimi, një sërë detyrash të reja me karakter imediat dhe perspektiv, të përcaktuara këto, së pari nga qëllimi i madh i Partisë «... që, duke ndërtuar socializmin, të formojë dhe të farkëtojë njeriun e ri komunist, me botëkuptim të shëndoshë politik dhe teorik marksist-leninist, me shpirtin revolucionar, sulmues, të guximshëm, krijues dhe realizues marksist-leninist».

Por për t'u bërë i tillë, brezi i ri duhet të formojë më parë ndërgjegjen revolucionare, me botëkuptim revolucionar, si kusht i domosdoshëm për veprimin revolucionar.

Në fjalën e 13 majit, midis së tjerash, shoku Enver thotë:

Do të jetë një gabim i rëndë dhe me pasoja të dëmshme të pallogaritshme, në rast se... nuk farkëtohet tek nxënësit e studentët edhe ndërgjegjja e tyre

proletare, nuk ngrihet në një nivel të lartë ndërgjegjja politike, nuk shpjegohet e nuk kuptohet çdo gjë në dritën e teorisë marksiste-leniniste, në dritën e luftës së klasave».

Ndaj kësaj detyre kaq të madhe dhe të komplikuar, me karakter të theksuar historik, vendimtar për fatet e socializmit, edhe letërsia jonë e re për fëmijë duhet të përqëndrojë vëmendjen kryesore, duke e kthyer veten në një mjet të fuqishëm për përvetësimin nga brezi i ri i koncepteve marksiste-leniniste për luftën e klasave.

Këtë detyrë shkrimtarët dhe letrarët tanë për fëmijë po e kuptojnë gjithmonë e më mirë e më thellë, duke e materializuar edhe me një numër krijimesh, që kanë pasuruar ndryshimet cilësore, që kanë filluar të bulojnë edhe në fushën e letërsisë sonë për fëmijë. Një ndër to është edhe poema «Artan borizani dhe çeta e tij» e shkrimtarit Bedri Dedja.

Pikërisht sukcesi apo vlera e veçantë ideo-artistike e kësaj vepre, për mendimin tim, qëndron në radhë të parë në konceptimin e gjërë dhe të thellë ideopolitik revolucionar të fëmijëve-personazhë, të ngjarjeve që i rrethojnë ata dhe të veprimeve të tyre krijuese.

E theksojmë këtë, sepse në disa krijime të letërsisë sonë fëmijët shikohen nga një kënd i ngushtë dhe i njëanshëm.

Në njerën prej tyre, midis të tjerash, thuhet:

Fëmijë të dashur,
«lule të jetës sonë»

lule do mbeteni përgjithmonë! . . .

Është e qartë se një konceptim i tillë i rrethon fëmijët me një frymë të sëmurë sentimentale, i rrit dhe i edukon si «filiza të njomë» që dhe «era» më e lehtë mund t'i përkulë dhe mund t'i thajë; një konceptim i tillë frenon e paralizon çdo orvajtje, çdo përpjekje e mendim për të edukuar tek ata tipare të larta moralopolitike, pra, u errëson perspektivën revolucionare.

Është e vërtetë se fëmijët prej natyre janë si «lulet» që na i zbukurojnë jetën, por asnjëherë nuk duhet harruar, bile me tendenciozitet të theksuar ideo-politik revolucionar, se ata janë në radhë të parë «luftëtarët», «komunistët e vërtetë» apo «gardistët proletarë» të së ardhmes. Si të tillë ata duhet të rriten dhe të edukohen në të gjitha hallkat e shoqërisë sonë. Një rol të rëndë-

sishëm lot sot shkolla e jonë e re me trikëndëshin revolucionar mësim-punë prodhuese, edukim fizik e ushtarak, duke patur si bosht të kuq edukimin ideologjik.

Në këtë vatrë të rëndësishme fëmijët, dhe në përgjithësi brezi ynë i ri, kalon relativisht një kohë të gjatë, prandaj një pjesë e mirë e jetës dhe e veprimtarisë së tij është e lidhur me problemet e shkollës.

Bash për këtë arsye mund të themi se shkolla ka tërhequr gjithmonë vëmendjen e letërsisë sonë për fëmijë dhe në linjën e zhvillimit të saj problemet e mësimi dhe të edukimit shkollor kanë zënë një vënd të dukshëm.

Kohët e fundit, me kënaqësi, vëmë re se nëpër faqet e veprave letrare për fëmijë fryn era e revolucionarizimit të shkollës sonë, spikatin idetë e reja lidhur me rritjen e rolit të saj për edukimin e brezit të ri. Bile do të gjesh krijime që e kanë vënë veten e tyre në radhët e para të luftës së partisë sonë kundër koncepteve të huaja borgjeze revizioniste, kundër koncepteve prapanike e reaksionare lidhur me mësimin:

*Çeta jonë
për mësim
shembull jep në përparim,
sepse dihet,
pa mësuar,
Asnjë punë s'do filluar.*

.....
*sepse nesër në uzinë,
ne e dimë,
çdo maqinë
punëtorin do ta ketë
sigurisht me fakultet,
kurse bujku me diplomë,
do të duhet agronom.*

*E që punët t'ecin mbarë,
s'do të jemi më të ndarë
ti me libër e gjyslykë,
unë artist me byzlykë.*

.....
*çdokush nesër do të rrokë
kazmë e pendë e pushkë tok!*

Një letërsi e tillë ka si synim të edukojë tek lexuesit e vegjël konceptin revolucionar dhe socialist «të mos lodhemi kurrë së mësuari, të mos e ndëpresim asnjë-

herë studimin, po ta vazhdojmë atë dhe pas shkollës», «duhet të mësojmë, se pa dituri nuk mund t'i shërbejmë si duhet popullit, atdheut, shoqërisë, socializmit».

Por jo gjithmonë, në letërsinë tonë për fëmijë mësimi është shikuar në këtë aspekt, bile në ndonjë rast është trajtuar edhe shtrembër nën ndikimin e koncepteve të huaja, që i japin prioritet edukimit mendor, që e konsiderojnë shkollën vetëm vend për të mësuar, që e shkëpusin mësimin nga edukimi.

Natyrisht, një konceptim i tillë i të mësuarit u hap shteg edhe në letërsi tendencave intelektualiste, egoizmit dhe individualizmit mikroborgjez, mendjemadhësisë dhe fodullëkut, e kthen mësimin në qëllim në vetvete.

Kështu, pra, do të gjesh qëndrime dhe gjykime të rriturish, që e vlerësojnë fëmijën nga notat e shkëlqyera, që i vënë si stimul për të mësuar interesin e ngushtë personal, «akulloren» apo «kinemanë»; do të gjesh fëmijë që brohorasin e këndojnë për dhjetat që marrin; do të gjesh shkrintarë, që kultivojnë tek fëmijët e vegjël një koncept të tillë të shtrembër dhe të rrezikshëm për shkollën, mësimin dhe punën:

*Tani që jam në shkollë
me zell gjithnjë mësoj,
por kur të vijë vera
edhe unë do punoj.*

Çdokush nga ne duhet ta ketë mirë të qartë se mësimi nuk mund të shkëputet nga jeta, as jeta nga mësimi, puna mendore nuk mund të shkëputet nga puna fizike, as puna fizike nga puna mendore, se edukimi i gjithanshëm komunist nuk mund të arrihet pa lidhjen organike të mësimit dhe të edukimit nëpërmjet punës, si një parim themelor i edukimit komunist.

E theksojmë këtë, sepse në letërsinë tonë për fëmijë punës i është dhënë më tepër një vend kryesisht si një aspekt i edukimit moral duke mos dalë në plan të parë si duhet vlera kolosale politike, ideologjike dhe pedagogjike e këtij problemi të madh edukativ jo vetëm për fëmijët, por për këdo.

Ne duhet t'u edukojmë fëmijëve konceptin se puna është pjesë përbërëse e jetës së njeriut, është kuptimi i vërtetë dhe i bukur i jetës së tij, që fëmijët ta shikojnë dhe ta çmojnë bukurinë e njeriut jo «tek flokët derdhur gjer në tokë» apo tek «fundi, bluza krejt nailon e katër metra me zhupon, me çorape manushaqe, me dy vëthë

posi harqe», por «nga kallot nëpër duar» të ndjehen «fort të gëzuar» dhe të kuptojnë se:

*Kush bën naze,
rri rehat,
dit' e natë në krevat
dhe kërkon veç mish e vezë
ngjet nga shpirti me borgjezë.*

Jam i mendimit se edhe problemet e kalitjes fiziko-ushtarake duhet të çajmë kornizat e tyre të ngushta ideo-tematike nga lodrat me topa bore, nga «bëj gjimnastikë me trupin si llastikë» apo «eci një-dy si ushtarët» duke i pasuruar ato gjithmonë në planin më të gjërë ideo-politik.

Për këto arsye, që letërsia jonë për fëmijë të përmbushë me sukses misionin e saj të madh për edukimin e brezit të ri me tiparet e revolucionarit të vërtetë, problemet e edukimit ideopolitik duhet të marrin një rëndësi të dorës së parë.

TONIN SHIROKA

Të shkruajmë më shumë për teatrin e kukllave

Për vetë faktin se teatri i kukllave brenda një pesëvjeçari dha 28 premiera me 2500 çfaqje jo vetëm në sallën e vet të vogël, por edhe në të katër anët e atdheut, në fshat e në qytet, — dhe këto çfaqje i panë rreth 370.000 spektatorë të vegjël, — vlerësimi i këtij institucioni duhet parë si nga ana e rolit edukativ, ashtu dhe nga ana ideoartistike. Mjafton të themi se gjatë jetës së vet njëzetvjeçare, ky teatër ka dhënë mbi 100 premiera dhe e ka kaluar që prej kohësh numrin e njëmilion spektatorëve.

Fëmijët e duan këtë teatër. Ata, me plotë të drejtë, e quajnë të tyren. Në se letërsia për fëmijë u tregoi

atyre shumë gjëra të bukura dhe edukuese, edhe Teatri i kukllave e bën këtë gjë. Për më tepër, me anë të komponentëve të saj, si interpretimi, kuklla, muzika, skena, dritat etj. e konkretizon edhe më tepër idenë duke e bërë më të kuptueshme e më të kapëshme për moshën e vogël.

Teatrin e kukllave e ka shqetësuar vazhdimisht problemi i repertorit. Siç është mielli për furrтарin, ashtu është teksti i pjesës për teatrin. Është e vërtetë se ka disa shkrimtarë, të cilët kanë dhënë një kontribut mjaft të bukur me pjesët e tyre si B. Dedja me «Gjyqin e Maçokut» dhe «Ushtarin prej plumbi», B. Gaçe me «Ngjarje në bregdet», K. Jakova me «Dhitë e egra» etj., por ky numur i vogël i teksteve të paraqitura nga shkrimtarë për fëmijë, nuk ka qenë i mjaftueshëm për të plotësuar nevojat.

Këtë problem Teatri i kukllave e ka zgjidhur me forcat e veta. Tek hyrja e teatrit nuk u vendos lajmërimi «Çfaqje nuk ka, sepse nuk kemi tekste teatrale», por pjestarë të kolektivit morën pendën dhe, duke e njohur konkretisht specifikën e këtij teatri, shkruan pjesë, të cilat, në fakt, patën përgjithësisht vlera ideore dhe artistike dhe kontribuan kështu për edukimin e fatosave e pionierëve. Le të përmendim Xhavit Sallakun, Andon Panon, Pleurat Armirin, Ibrahim Brahon, Tonin Shirokën e të tjerë.

Por prapë, drejtorja e këtij teatri e ka shtruar me forcë avitjen e firmave të reja letrare. Për këtë janë bërë takime me letrarë, por afrimi i tyre nuk ka qenë i kënaqshëm.

Mendoj se ky problem duhet t'i shqetësojë të gjithë shkrimtarët për fëmijë. Numuri i madh i spektatorëve, që frekuenton këtë teatër, na ve një barrë të rëndë të gjithëve. Ata e presin me padurim shfaqjen. Ne duhet të kemi kujdes të madh. Shfaqjet tona duhet të kenë frymën e kohës, problemet t'i shtjellojmë sa më drejt, dhe me vlerën artistike të spektaklit të bëjmë që të komunikojë sa më drejt idea kryesore.

Së shpejti teatri i kukllave do të hapë një konkurs për pjesë teatrale me kuklla. Përfitoj nga rasti t'i ftoj të gjithë shkrimtarët për fëmijë që t'i përgjigjen që të gjithë kësaj thirrjeje, se me veprat që do të paraqesin, do të kontribuojnë edhe ata për edukimin e fëmijëve tanë me mësimet e Partisë.

Më shumë pjesë teatarle për fëmijët tanë!

Dramaturgjia për fëmijë ka një fushë shumë të hapët veprimi, ma të gjanë se asnjë sektor tjetër, këtu kemi edhe format ma të thjeshta të dramaturgjisë, edhe ato ma të vështirat. Kështu, kemi teatrin me hije dhe teatrin në relief për parashkollarët, teatrin e kukllave për shkollarët e vegjël, skeçet e estradave për fëmijë, dramat dhe komeditë, libretet për tablo, opereta, opera, e skenarët e filmave.

a) — **Për teatrin me hije dhe teatrin në relief**, nevojiten pjesë fare të thjeshta me 2-3 ose 4 personazhe (realë apo fantastikë). Do të ishin njëfarësoj skeçesh apo dialogjesh të shkurtër 2-3 faqesh me subjekte nga përrallat apo ngjarjet e thjeshta. Nuk ka edukatore, e cila të mos e ndjejë mungesën e këtyne punimeve të thjeshta, por shumë të nevojshme për edukimin e fatosave të vegjël. Ndokush mund të vërejë se ku asht këtu dramaturgjia, një dialog dy faqesh me një lepurush e një dhelpër si personazh?!... Por kjo asht dramaturgjia e 3-vjeçarëve!... Na atyne nuk mund t'u lozim as Ibsenin, as Brehtin e as dramet e Kolë Jakovës. Por atyne e kemi për detyrë t'u japim artin. Ushqimi i fëmijëve të kopshtit ka një meny që përmban të gjitha substancat siç kanë dhe ushqimet e të mëdhenjve. Vetëm doza asht ma e vogël. Këte duhet ta kemi parasysh dhe për ushqimin mendor e shpirtnor të të vegjëlve. Askush nuk na autorizon t'i privojmë nga ky ushqim i dytë po aq i randësishëm sa i pari.

Dikush tjetër mund të thotë: ku marrin vesh 3-4 vjeçarët nga këto punë? Eni e shihni në kopshte: një teatër me hije, pa një fabul të bukur, të punuëm shkel e shko, fëmijët s'ta përfillin fare, bajnë zhurmë në sallë (jo tue rrahë kambët e me fishkëllima, por zhurmën e mospëlqimit — karakteristikë e fëmijëve). Kurse një pjesë të bukur e dëgjojnë në heshtje, e duartrokasin në fund dhe, ajo që ka randësi, mësojnë prej saj.

b) — **Teatri i kukllave**. Në Tiranë ka një teatër të tillë profesionist. Në disa rrethe ka amatorë. Tepër pak. Shumë mirë që fëmijët e kryeqytetit shohin vazhdi-

misht, që fëmijët e Shkodrës, Korçës apo ndonjë rrethi tjetër kënaqen herë pas here, por na kemi nevojë ta shohin teatrin e kukllave dhe fëmijët e Apripës së Keqe, ata që ende s'e dijnë ç'është një teatër i tillë. Na jemi në gjendje t'u ndërtojmë atyne mbrenda pak vitesh gjigantit e Fierzës e të mos jemi të zotët t'u dërgojmë dy herë në vit nga një trupë teatroshe të kukllave? Këtë lind nevoja e madhe e domosdoshme e krijimit të sa ma shumë teatrove të tilla profesioniste e, si pasojë, mbajtja e tyne me repertor.

Po qe se na s'kujdesemi për të vegjëlit tanë — nuk shkojmë deri tek kukllat e tyne — është një lloj sikur të kujdesemi vetëm për pyjet e rritun e të mos mendojmë fare për fidanat. E, pra, duhet të kujdesemi kryesisht për fidanat.

c) — **Skeçet për estrada, komeditë dhe dramat.** Këtu duhet të sqarojmë se për këto punime nevojiten tri lloje: e para: skeçe, komedi ose drama me personazhe të gjithë fëmijë. Këto punime nevojiten për manifestimet shkollore, (pse të mos bahet traditë që çdo shkollë në fund të vitit shkollor të pregatisë dhe një çfaqje?) nevojiten për Shtëpitë e pionierëve e institucione të tjera.

e dyta: skeçe, komedi ose drama me personazhe fëmijë dhe të rritun.

e treta: skeçe, komedi ose drama vetëm me të rritun, por të destinueme për fëmijë.

Këto dy llojet e fundit u duhen kryesisht trupave profesioniste të estradave dhe teatrove, radio-televizionit, etj.

Me këto lloj veprash bajmë dy të mira: e para, edukojmë fëmijët; e dyta, me pjesëmarrjen e tyne, nxjerrim kuadrot e nesërme për aktorë. Mos të harrojmë se një pjesë e mirë e aktorëve tanë kanë fillue jetën e skenës që në bangot e shkollës.

ç) — **Libretet për tablo, opereta, opera.** — Shokët e muzikës kanë të drejtë të qahen. Shumë pak materiale të tilla u japin në dorë. Na jemi në hapat e parë të këtyne punimeve, por vlera edukative e tyne duhet të na nxisi. Edukojmë fëmijët tanë me moralin tonë komunist, me shijen e së bukurës, me muzikën, me teatron njëheri. E përveç këtyne tërheqim masën e fëmijëve nga rruga në skenë. Shtëpia e Pionierit në Shkodër vetëm për pregtitjen e një opere tërheqti për dy muaj 120 fëmijë në një aktivitet të kulturuem. Fryti i pasojave është i pallogaritshëm.

d) — **Skenarët e filmave.** Me shtimin e prodhimtarisë së kinostudios dhe me krijimin e televizionit, shtohen natyrisht dhe kërkesat për skenarë.

Mund të mendohet se ç'të shkruejmë ma parë? U dashkan vetëm vepra dramatike që nga parashkollarët deri tek universitarët, që nga djalogjet e thjeshta deri tek skenarët e filmave! Sikur të gjithë shkrimtarët tanë, të vjetër e të rinj, të jepnin vetëm nga një vepër, besoj se do të kishim një fond të mirë. Këtë e tregoi dhe konkursi i madh i 25-vjetorit, ku sasia e punimeve për fëmijë qe e konsiderueshme.

AGIM FAJA

Ilustrimi në botën e fëmijëve

Ilustrimet luajnë një rol njohës dhe edukativ bile në disa raste edhe më shumë se teksti. Ato ndihmojnë në konkretizimin e objekteve dhe bëhen kështu burime njohurish, duke zhvilluar imagjinatën dhe fantazinë dhe duke edukuar shije të bukura estetike.

Kur Bjelinski shkruante se «po të jetonte Lermontovi, do ta kishte quajtur «Demoni-n» jo vepër të tij, por të Urubelit» nuk kishte ndërmend të ulte forcën e madhe të veprës së poetit, por të ngrinte dinamikën, origjinalitetin dhe atë vrull të fuqishëm, që përshkon këto ilustrime të piktorit të madh.

Ilustrimet, si bashkëudhëtare të një libri, janë stacione, që ndihmojnë lexonjës të zgjerojë përfytyrimet e personazheve apo të ambienteve që përshkruhen në atë libër. Ato janë të nevojshme edhe për romanet, edhe për vëllimet me tregime dhe mendoj se ka ardhur koha tek ne të dalin libra të ilustruar bukur, siç kanë filluar të dalin kohët e fundit dhe janë arritur suksese të dukshme. Por ende më të nevojshme ato bëhen në librat për fëmijë, gjithë kjo rrjedhë e vrullëshme e jetës me problematikën e saj mendoj se duhet trajtuar në thellësi dhe gjerësi jo vetëm në letërsinë për fëmijë, por edhe në ilustrimet e kësaj letërsie.

Piktori ilustrator nuk është vetëm një ilustrues i thjeshtë i veprës së shkrimtarit dhe i bëmave të tij (e kam fjalën gjithnjë për letërsinë për fëmijë), përkundrazi ai mund të zhvillojë edhe më tej mendimin e shkrimtarit dhe ta paraqesë në një formë më të avancuar mendimin e tij artistik. Nuk ka dyshim se kjo kërkim përppjekje nga ana e piktorit për të gjetur gjuhën dhe mjetet e tjera shprehëse. Dhe këto përppjekje janë dukur në një seri librash si: «Treni ynë», «Arushat ngrehin një fole», «Ne jemi gjeologë», «Anës detit», «Këngë në kopësht», «Artan burizani dhe çeta e tij» etj.

Duke parë të gjitha librat e ilustruara për fëmijë vihen re dy prirje në realizimin e këtyre ilustrimeve. Prirja e parë është përppjekja për të pasqyruar idenë e shkrimtarit në mënyrë përgjithësuese, d.m.th. merret një moment si më kulminant i pjesës dhe ilustrohet. Në këtë rast kemi shpesh zgjidhje simbolike siç ndodh, fjala vjen, në librin «Këngë në kopësht», dhe «Numrat», të piktores Safo Marko, «Zilja e saj na fton» dhe «Treni ynë» të piktorit Llambi Blido, «Arushat ngrehin një fole» e piktorit Ksenofon Dilo etj., gjë që duket nga kompozimi i figurave, nga mendimi që i përshkon këto ilustrime si edhe nga elementet rrethonjës të ambjentit.

Megjithatë, këto zgjidhje janë sa interesante aq edhe të ndërlikuara. Nganjëherë ato të çojnë në një farë paralelizmi dhe skematizmi të atillë që bëhen qëllim në vetvete dhe nuk komunikojnë me botën e brëndshme të fëmijëve, madje edhe bien në kundërshtim me vetë kërkesën themelore të pjesës si, për shembull, në librin «Numrat», ku fëmijëve, të veshur herë me kostume kombëtare e herë me rroba ushtarake (pa ndonjë qëllim të caktuar) u vihen në kokë, në duar në shpatulla e në shpinë numrat 1, 2, 3 deri në 10 (pa ndonjë kriter). Ose ndodh që nuk zërthehet psikologjia e fëmijëve dhe piktori merret vetëm me njolla herë-herë edhe të pakonstruktura mirë e të lëshuara pa shumë përgjegjësi si fjala vjen në librin «Në parkun e lojnavë» të piktorit Vlash Dobroniku etj.

Prirja e dytë është transmetimi ose ilustrimi me përppikmëri i veprës letrare. Edhe në këtë drejtim vihen re suksese të dukëshme. Të këtilla janë librat «Shtëpia e re», «Brigadierja», «Artan burizani dhe çeta e tij», «Goni trazovaçi» të piktores Safo Marko, «Shpendi» e piktorit Llambi Blido, «Ne jemi gjeologë» e Spiro Kristos, «Ata ishin shtatë» dhe «Anës detit» të Dollit Gjinalit etj.

Është e natyrëshme se këto suksese janë rezultat i punës së madhe që kanë bërë piktorët ilustratorë kohët e fundit, duke e ndjerë veten jo vetëm si ilustrues të thjeshtë të veprës së shkrimtarit, por si bashkëautorë.

Megjithatë, piktorët duhet të jenë ende më kërkues ndaj vetes, sepse ndodh që brenda një libri prej 40 faqesh, siç është «Zilja e saj na fton», kemi një ekspozitë piktorësh (nga koncepti i stilit), megjithëse kemi të bëjmë me një piktor të vetëm. Shikon, pra, ilustrime me linjë të zezë e pa linjë të zezë, me ngjyra e me bardhë e zi, të stilizuara tepër dhe të pastilizuara fare; më e keqja është se shohim herë fëmijë të karikaturizuar e herë të vizatuar me përsosmërinë më të madhe (e kam fjalën gjithnjë brenda një libri). Larmia e një libri nuk vjen nga futja e shumë stileve në të, përkundrazi, kjo sjell një farë prishje uniteti që nuk të ngjall emocione. Ose, siç ndodh në librin «Shpendi» të po këtij autori, ku figurat e partizanëve apo të djemve që i ndihmojnë ata janë të vizatuara me korektësi, ndërsa të xhandarëve kalohen plotësisht në prehërin e karikaturës.

Problem tjetër është edhe ngjyra kombëtare e ilustrimeve tona. Të kuptohemi drejt. Nuk e kam fjalën për t'i veshur figurat me jelekë si dhe me brekushe të bardha, me qeleshe apo me opinga, se pastaj do të binim në pozitat e atij që thirri: «Deti shqiptar» kur pa një qeleshe të notonte nëpër valët e detit. Jo, jo! Ndoshta edhe duke i veshur kështu ilustrimet nuk do të merrnin ngjyrën nacionale, por, duke studjuar botën e fëmijëve, atë botë plot komplekse nacionale, me psikologji e horizonte, me kërkesa dhe dëshira të organizuara, duke e zberthyer më parë atë botë pa ndikime. Dhe të këtilla kemi shumë.

Ndërsa dy librushkat, «Ariu fotograf» dhe «Poku çamaroku» për vetë kolorilin ndërtimin dhe të kompozuarit, për vetë konceptin që i përshkon, të sjellin ndërmend piktorë të huaj si Arnali, Disnej, Sutjejevi apo ndonjë tjetër. Madje herë-herë i kupton si të ishin të tyre, sepse mbetesh dhe skllav i stilit të tyre.

Veç kësaj, në ilustrimet e letërsisë për fëmijë mendoj se duhet patur parasysh dhe veçoria e moshës së fëmijëve që u drejtohet ky libër. Pikërisht kjo do të përcaktojë dhe karakterin e ilustrimit. Pikërisht kjo është dhe ana më e dobët dhe më e vështirë, sepse një ide e caktuar për fëmijë të moshave të ndryshme do trajtuar ndryshe.

Nuk mund të përcaktoj këtu se cilat ilustrime janë më të përshtatshme: ato me njolla dekorative apo ato me vëllime, ato të detajuarat apo ato të trajtuara në mënyrë të përgjithshme. Kjo ka të bëjë me kërkesën e librit se kujt moshe i drejtohet.

Dhe për librat «Këngë në kopësht» të Safo Markos, «Treni ynë» të Llambi Blidos, «Ne jemi gjeologë» të Spiro Kristos apo «Ata ishin shtatë» të Dolli Gjinalit ne mund të themi plot fjalë të mira, sepse janë libra që jo vetëm zbërthejnë bukur idenë e autorit, por edhe komunikojnë me fëmijët, dhe edukojnë shije estetike.

Që ilustrimet tona të gjejnë një realizim të denjë dhe të plotë artistik, mendoj se piktorët ilustrues duhet të kenë parasysh disa probleme. Është mirë, sipas meje, që ata të bredhin nga kopshti në kopësht e nga çerdhja në çerdhe, nga shkolla në shkollë e nga lagja në lagje, duke vizatuar vazhdimisht tipe fëmijësh e duke mbledhur materiale brutto, që nesër do t'i përdorin në këtë apo atë ilustrim. I them këto, pasi ndodh që disa ulen në tavolinë dhe i realizojnë ilustrimet pa përgjegjësi, pa e nxjerrë materialin nga jeta e fëmijëve, pa e njohur botën e tyre të madhe shpirtërore, psikologjinë e tyre. Kjo sjell krijimin e një tipi fëmije, i cili futet kudo e ngado si pykë (ajo është pjellë e fantazisë së autorit). Pa tjetër kjo sjell një monotoni të madhe dhe bën që libra të shkrintarëve të ndryshëm të duken sikur janë të një shkrintari. Dhe e gjithë kjo bëhet vetëm për faj të piktorit.

Mendoj gjithashtu se është e domosdoshme që piktorët të lidhen më shumë me tekstin e shkrintarit. Vërtet që piktori e çon më tej mendimin e shkrintarit, por jo të bëjë tren blu kur flitet për tren të kuq, apo djalosh me kapele kur aty nuk flitet për një gjë të tillë. Historira të kësaj natyre ndodhin shpesh e sidomos në revistën «Fatosi». Ose ndodh që në ilustrime futen figura policësh (kur është rasti që flitet për policë edhe në tekst) si ato të kohës së Pjetrit të Parë, me mustaqe të bardha e me syze. Po me ato tipare, por pa kapele, diku gjetiu bëhet muratori.

Jam i mendimit që piktorët ta vlerësojnë më drejt punën e ilustrimeve, sidomos të atyre për fëmijë, ta vlerësojnë si një gjini shumë të vështirë, që kërkon durim, vullnet, shpirt të gjërë dhe dashuri të madhe. Të mos nisen nga mendimi vulgar «... hë, mo, për fëmijë është, punë e madhe!» pa u kushtuar kështu kujdes as

ngjyrave dhe as vizatimit. Shpesh nga të rriturit, goftë edhe nga edukatorët, pëlqehen ilustrime bajate, anakronike dhe pa jetë dhe jepen mendime të kësaj natyre: «Ja, këto pëlqejnë edhe fëmija; ç't'u bëjmë?» (!)

Në goftë se në prirjen për t'i stilizuar figurat, (pa rënë në stilizëm natyrisht) vërehen përpjekje për të ecur më tej, për t'u shkëputur nga e vjetra, në ilustrimet anakronike bie në sy një kompromis me të vjetrën dhe mbetja në vend.

Unë mendoj se është e domosdoshme t'i kushtohet një vëmendje e veçantë punës me të vegjëlit, edukimit të gustos dhe të shijeve të tyre. Dhe një pjesë e këtij misioni u është besuar piktorëve ilustrues.

Edukimi me shijë estetike i fëmijëve tanë ka një rëndësi të veçantë sepse do të edukohet kështu një brez që do të shikojë me sy kritik çdo vepër arti, të vjetëruar dhe pa forcë emocionale, pa brendi dhe do të çmojë atë, të partishmen, militanten, atë që pasqyron aktualitetin e jetës sonë në të gjithë zhvillimin e saj revolucionar.

Një rol mendoj se do të luajë edhe kritika artistike, e cila, krahas vlerësimit të veprave nga ana letrare, duhet të mbajë një qëndrim edhe për anën e ilustrimit, aq më tepër kur jemi në hapat e krijimit të këtij arti të ri.

SHEFIK OSMANI

Letërsia për fëmijë dhe tekstet mësimore

Botimi i çdo libri të ri, vjershe, poeme apo drame të mirë për fëmijë, ne, mësuesve, na gëzon. Edhe iniciativa e Lidhjes për të organizuar këtë plenum na mbush me shpresë. Ky plenum bëhet në fazën kur shkolla jonë ka hyrë në rrugën e revolucionarizimit të plotë të saj, kur 20.000 mësuesët dhe dhjetra e dhjetra autorë tekstesh të reja janë mobilizuar për të vënë në jetë detyrat, që shtron plenumi i 8-të i Partisë dhe porosinë e shokut Enver për edukimin e njeriut të ri më

normat e moralit komunist. Kuptohet që për plotësimin e këtyre detyrave ne kemi pasë nevojë për ndihmën e shkrimtarëve, për veprat e tyre që fatmirësisht siç u tha dhe në raport, kohët e fundit nuk kanë qenë të rra-lla. Me subjektet e shëndosha të këtyre veprave dhe me personazhet e tyre që përfaqësojnë jetën tonë të re, me Artan Borizanin, me gurëskalitetit e Beratit etj. ne zgjidhim probleme të caktuara edukative për atë periudhë moshe kur fëmija troket në dyert e jetës dhe fillon të marrë pjesë aktivisht si një pjestar i saj i gjallë.

Copat e reja të këndimeve, të leximeve letrare, pjesët e bukura, që shoqërojnë mësimet e historisë, të gjeografisë, të shkencave, leximet jashtë klase, aty e kanë burimin ushqimor. Emrat e B. Dedes, I. Kadaresë, B. Gaçes, A. Mamaqit, Gj. Zhejit, N. Jorgaqit, si dhe të disa shkrimtarëve, që më parë kanë shkruar, por tani o e kanë braktisur këtë fushë ose na kujtojnë fare rra-llë, janë emra të njohur, emra të dashur për afro 496.000 fëmijë të moshave 6-12 vjeçare.

Po kështu janë të njohur për fëmijët dhe A. Faja, S. Marko, P. Mele, Z. Shoshi. Siç doli dhe në raport ne tani flasim me gojën plot për gjini të ndryshme letrare, për forma të reja në artin figurativ të letërsisë për fëmijë. Por si në çdo fushë të jetës sonë të re dhe në letërsi e në artet figurative për fëmijë, kërkesat janë në rritje. Të kënaqurit me pak tanimë nuk ka më vënd në aktivitetin tonë.

Duke u nisur nga të dhënat pedagogjike që moshat 6-12 vjeçare është periudha më e përshtatshme për formimin e shprehive, nëpërmjet të cilave fëmija formon karakterin, gama e kërkesave për këtë letërsi është e madhe dhe akute.

Probleme të tilla si shtrirja në tërë amplitudën e vet e temës së edukimit patriotik, e galerisë së personazheve që përfshin tërë jetën e vendit tonë dhe që u trajtuan në raport janë kategorike për plotësimin e kërkesave të programeve të reja të shkollës. Shkrimtarët duhet të lidhen më shumë me ne, të na ndihmojnë më shumë, mos të na i mbyllin portat. Këto probleme u kaluan në mënyrë tangente në raport, por çeshtja e drejtimit të syve nga letërsia për fëmijë duhet të jetë më e fuqishme, duke menduar se këta janë gjeneratat e ardhme dhe ne do të edukojmë tek ata bindjet shijet, pikëpamjet dhe botëkuptimin e partisë sonë.

Edhe problemi i adresimit moshave u shtrua në ra-

port dhe lidhur me këtë u fol edhe për problemin e gjuhës, për heroin pozitiv e negativ etj. Lidhur me këtë do të thoshja se duhet mëshuar theksi në njohjen më të thellë të fëmijëve, të botës së tyre dhe të interesave të tyre. Duke e shikuar problemin nga ana pedagogjike, p.sh., problemi i gjuhës për fëmijë nuk është vetëm thjeshtësia e fjalorit, por edhe ndërtimi i frazës. Një nga kërkesat tona themelore për ciklin e ulët është leximi shprehës i rrjedhshëm, me ton etj. Gjoksi i nxënësit të vogël, frymëmarrja e tij, diapazoni i shikimit janë të kufizuara. Prandaj këmbëngulja e disa shkrimtarëve për të shkruar fraza të gjata ose edhe periudha për nxënësit e ciklit të ulët bën që redaktorët t'i përpunojnë dhe në ndonjë rast dhe i cungojnë. Ja përse ngulim këmbë ne në njohjen e disa veçorive fizike, fiziologjike e psikologjike të fëmijës.

Ne e dimë se tek nxënësit e klasës I-II të ciklit të ulët cilësia kryesore e vullnetit të tyre është imitimi. Duke u nisur nga kjo, jemi të mendimit që vendin kryesor në letërsinë e kësaj moshe ta zërë shembulli pozitiv, i cili edukon drejtpërsëdrejti dhe me tërë përmbajtjen e tij si dhe udhëheq drejt asaj që ne kërkojmë. Edukimi nëpërmjet shembullit negativ ose të tipizuarit mund të zerë vënd në klasat e larta kur nxënësit fillojnë të arësyetojnë dhe të abstragojnë, por këtu natyrisht nuk duhet tepëruar.

Si bashkëudhëtar të pashmangshëm të copave letrare, tregimeve, përrallave, vjershave etj. ilustrimet lozin rol njohës dhe edukativ sa edhe fjala. Në moshat e vogla kur fëmijët flasin më shumë me figura se sa me fjalë, më shumë me shembuj se sa me moralizime, figura bëhet një nga mjetet më të përshtatshme për të komunikuar me to. Figurat nxisin fantazinë dhe imagjinatën, edukojnë shijen dhe guston e nxënësit. Por kompozimi i tyre nga ana e piktorëve i duhet nënshtruar disa kërkesave didaktike që të shërbejë si urë lidhëse me ambientin rrethues dhe të arrijë qëllimin që fëmijët t'i kapin më shpejt fenomenet e reja në jetën dhe shoqërinë tonë.

Këtu kemi të bëjmë me dy lloj ilustrimesh: ilustrime për letërsinë artistike dhe ilustrime me karakter didaktik për tekstet shkollore. Të dy këta lloj ilustrimesh kanë tiparet e veta. Ndërsa në ilustrimin e një cope artistike ne gjejmë momentin kulminant, momentin kyç ose një kuadër përgjithësues të tipareve kryesore të

asaj që përshkruhet, në materialet që kanë karakter didaktik ilustrimi është në funksion të programit, të qëllimeve arësimore dhe edukative të metodës që do të shërbejë për ngulitjen e njohurive të reja. Si pasojë lind nevoja e profilizimit të disa piktorëve, sepse ka ndodhur që edhe piktorë me përvojë ngatërojnë tiparet ose i identifikojnë. Në këtë drejtim rezultate të mira ka arritur A. Faja, autor me ekzigjenca ndaj krijimeve të tij për fëmijë si në fushën e ilustrimeve me karakter thjesht artistik ashtu dhe në atë me karakter didaktik. Duke mos ngatërruar rolet, duke ju përgjegjur qëllimeve edukative, A. Faja mbetet gjithmonë afër botës së fëmijëve. Me krijimet e tij në ilustrime të tipit «Shkolla e pyllit» ose «Këndimit» dhe «Arithmetikës» për kl. I, si dhe në pjesëmarrjen në revistën «Fatosi»; ai ka formuar fizio-nominë e vet në mënyrë të veçantë për moshën e ulët shkollore dhe në atë parashkollore. Me sukses kanë bashkëpunuar në këtë drejtim dhe S. Marko. Z. Shoshi, S. Kristo. Duke folur në plenumin e 8-të, sh. Enver në mes të tjerash porositi: «në të gjitha tekstet shkollore duhet të jemi këmbëngulës në ekzigjenca shkollore dhe pedagogjike të përmbajtjes dhe të paraqitjes...»

Në kuadrin e modernizimit të teksteve, ilustrimet kanë pjesën e tyre. Kur flasin për ilustrimet me karakter didaktik duhet patur qartë se ato shfrytëzohen si mjet pune në shkollë si nga mësuesi ashtu dhe nga nxënësit. Si të tillë ato kanë funksione të caktuara arësimore edukative. Kështu, ilustruesi do të vihet në pozitë e pedagogut dhe do të luftojë për realizimin e kërkesave didaktike dhe në kompozimin e tij, gjë që do të elektrizojë tek nxënësi lidhjet që qëndrojnë të frenuara dhe do t'i bëjnë ato burim njohurish të reja. I kuptuar dhe i realizuar në këtë mënyrë, ilustrimi krijon vatra nxitjeje në sistemin nervor të nxënësit dhe, si pasojë, e shtyn atë të zgjidhë detyrën e dhënë ose të dëpërtojë në brendinë e mësimit.

Në qoftë se ilustrimet do të mbesin të mbyllur në kornizën e simboleve, siç janë shumica deri më sot ato do të mbesin gjëra të vdekura. Ilustrimi duhet të zërë vëndin që meriton dhe të lozë denjësisht rolin që i përket, në vartësi të funksioneve edukative-arësimore e metodike. Në tekstet e reja dhe veçanërisht në ato të ciklit të ulët metoda e të vërejturit, e demonstrimit, e eksperimentit do të zërë vënd gjithnjë e më shumë. Prandaj arti didaktik i të ilustruarit do të ketë peshën e vet. Nxënësi do të mësojë të lexojë pikturat.

në qoftë se ilustrimi nuk ngjall imazhe të qarta dhe të sakta, por bie në formalizëm dhe në paraqitje sipërfaqësore, a mundet ta lexojë nxënësi?

Në qoftë se piktori, duke bërë paraqitjen e një bime ose karshe në shkencat e natyrës, nuk i mëshon asaj që është e qenësishme tek ajo bimë ose tek ajo kafshë, por e mbyllet me ambient, nxënësi i vogël nuk ka se ku të mbështetet për të njohur në imtësi ose për të riprodhuar njohuritë që merr. Në fazën që kalojmë, ky është një aspekt i domosdoshëm i modernizimit të teksteve tona. Piktorët duhet të qëndrojnë më afër shkollës dhe mos të rrimë duke i lutur.

Dua të shpreh gjithashtu një mendim lidhur me mënyrat e trajtimit që zotërojnë sot në artin figurativ për fëmijë. Duke u bazuar në rastet pozitive, deri në vitet e fundit, mbizotëronte forma e paraqitjes duke u mbështetur në pasqyrimin real të botës, të ambientit dhe të objekteve, trajtim ky që ishte pothuajse i vetmi për të dyja gjinitë, si për letërsinë artistike ashtu dhe për atë didaktike dhe që përfaqësohej nga P. Mele, Z. Shoshi, S. Marko etj. Kohët e fundit ka filluar të dominojë pasqyrimi i natyrës, ambientit dhe objekteve (kur është fjala për moshën e ulët) ashtu siç i perceptojnë fëmijët natyrën, ambientin dhe objektet. Ky trajtim përfaqësohet sidomos nga piktori A. Faja dhe tani vonë dhe nga një sërë piktorësh të tjerë. Në këtë trajtim ka filluar të debutojë dhe S. Marko («Artan borizani e çeta e tij»). Kjo shënon një hap të ri në artin tonë dhe patjetër ka anë pozitive sepse në shumë raste u përgjigjet veçorive karakteristike të moshës së ulët. Duke njohur mundësitë e kufizuara të kësaj moshe, piktorët përpunojnë ilustrimet e tyre në mënyrë të thjeshtë, pa ngarkesa të tepërta, në një plan perspektiv, por me ngjyra të gjalla dhe tone të përshtatura. Natyrisht këto ilustrime ruajnë formën e planeve ashtu siç i percepton fëmija objektet në hapësirë. Kjo kërkon njohjen e thellë të fëmijëve dhe të botës së tyre dhe jo paraqitjen me disa njolla siç ndodhi, p.sh., në ilustrimin e përmbledhjes me poezi të F. Malos. Ndërsa ky trajtim është mjaft i përshtatshëm për letërsinë artistike, për atë me karakter didaktik ku në shumë raste ka nevojë për detale dhe për një pasqyrim besnik të objekteve që do të mësohen mendoj se duhet përdorur me maturi. Ka ardhur koha që kritika jonë, krahas vlerësimit që u bën veprave nga ana letrare, të mbajë qëndrim dhe vlerat ideoestetike të ilustrimeve.

ADIL ZEKA:

Lidhja e fjalës me pikturën dhe me muzikën

Fatosave u pëlqen aksioni me një fabulë elastike dhe plot fantazi. Po i tërheq shumë edhe biseda lakonike, kallëzimi dinamik i shprehun me fjalë të kursyeme, këtu buron domosdoshmënia e prezencës së pikturës (ilustrimit) që plotëson fjalët e pathanuna dhe detajet e papërshkrueme me fjalë.

Tek raportit i drejtë midis fjalës dhe pikturës qëndron gjithë pesha e realizimit ideo-artistik të vjershës ose kallëzimit për fatosa. Pikërisht ky raport shkelet shpesh herë në plot krijime që kemi pa të botueme edhe vitet e fundit.

E meta nuk duhet kërkuar gjithmonë tek piktori, por tek të dy palët, sidomos tek mungesa e bashkëpunimit të ngushtë midis shkrimtarit dhe piktorit. Ky bashkëpunim nuk nënkupton gjithmonë kontaktin direkt midis tyre. Çfarë mund t'i bajë piktori një vjershe të gjatë të mbushun plot emna fëmijësh që dalin në livadh për të mbledhë një tufë lule për edukatoren? Ose një kallëzim me 10-15 strofa në vargjet e të cilit rimojnë në kollonë të pafund emra kafshësh që na hedhin vallen e pranverës në mes të pyllit në vend që të shtjellohet një fabul e gjallë edhe me fantazi?

Shkrimtari duhet ta nënkuptojë që ma përpara atë punë që do të mbetet për ta krye piktori.

Në mos distiku, të paktën strofa duhet të jetë patjetër korniza e një vizatimi që tregon moment veprimi, aksioni. Këte gja e kërkon sidomos fatosi i kopshteve.

Sa herë që e kanë pasë parasysh këtë kërkesë shkrimtarët tanë si B. Dedja, A. Mamaqi, Xh. Beqaraj, etj. kanë dhanë krijime të mira me të gjitha vlerat e përgjithësisimit artistik.

Problem më vete asht edhe kanga për fëmijët. Këtu mund të cekej në veçanti karakteri i teksteve të kangës për fëmijë dhe niveli i tyre ideo-artistik. Plot festivale të kangës për fëmijët zhvillohen sot nëpër rre-

the. Njëqind herë asht thanë nevoja e bashkëpunimit të ngushtë midis kompozitorit dhe shkrimtarit.


Kur ka bashkëpunim, ka edhe sukses. Këte e tregojnë shumë kangë të bukura dhe të qëllueme për të vegjëlit me autor tekstesh Adelina Mamaqi (Marangozat), Bekim Gaçe (Are, abetare), Xhevat Beqaraj, Sandër Gera, Lajde Staku, etj.

Mirëpo këta shembuj pozitivë të aktivizimit të shkrimtarëve për të dhanë tekste kangësh për fëmijë, janë të rrallë në krahasim me nevojat.

Të vjen keq se vazhdon të përsëritet e keqja kronike që tekstet ose i harton vetë kompozitori (pa art dhe pa mbrendi interesante) ose angazhohen firma të ndryshme për të thurë vargjet pasi asht ba muzika.

Një metodë e tillë pune sjell me imponim nevojën e përdorimit të disa fjalëve që janë ba rutinë e kangëve për fëmijë si: «ne, kënga jonë, sot, ja, he, kanga e re, me harë, jemi ne» etj.

Sot, jo vetëm për kangën për fëmijët, por edhe për kangën në përgjithësi, po shtrohet nevoja për ta përshekue atë një subjekt i kapshëm, i marrun nga jeta jonë. Pikërisht kangë të tilla si «Fatosi e qingji», «Neve jemi marangozë» etj. kanë gjetë përhapje masive ndër fëmijët.



FYTYRA TE GRAVE TONA

Fotografi nga PETRIT KUMI




**Gruaja
shqiptare
e zonja e
punës
që nga fusha
e deri në
teknikën
moderne.**





Vajzat aksioniste
Bija të revolucionit



Ju përshëndes
nga fshati
nga malësia!

brendëshme e motiveve dhe e cikleve, shmangia nga fraza dhe ritmi i prozës, kapërcimi i diletantizmit dhe i poezisë shkollareske.

Edhe figuracioni i poetit është i varfër dhe i thatë.

Autori nuk përdor sistemin metaforik figurativ, por është i dhënë më tepër pas figurës pa bujë, të thjeshtë. Megjithatë edhe figurës së tij i mungon konkretësia dhe lidhja me mendimin. Veç kësaj figura e tij shumë herë duket libeske, e ripërpunuar keq, dhe ç'është më e demëshme, e përshkuar nga një frymë romantizante e vjetëruar (p.sh. «e duam jetën të lirë si pulëbardha në det», «edhe në burg si çajkë qe i li-

rë», «dhe komisar trim me fletë», «agimi shpërndan shigjetat e arta», «gjeologët po ngjiten, komitëve u ngjasin ata», «qyteza e kantierë të tjerë, fidane të reja të jetës së re shqiptare»).


Kjo frymë romantizante merr fill që në titull, i cili nuk thotë asgjë për vëllimin.

Shumë nga këto të meta të vëllimit «Një gërshet i shturur», poezia jonë (edhe poezia e të rinjve) i ka kapërcyer me kohë dhe me shumë sukses. Përsëritja e tyre është hap prapa për të. Autorët tanë të rinj duhet të bëhen më këmbëngulës dhe më kërkonjës se kurrë.

Thanas Dino

Ngjarje kulturore artistike

EKSPOZITË E PORTRETIT



Ç. Ceka: Metalurgu i ri

Përpjekjet më të mira të kohëve të fundit, të shumë piktorëve (mbi 80), përbëjnë veprat e paraqitura në ekspozitën e organizuar nga Këshilli qëndror i BPSH dhe Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve, që u inaugurua më 10 shkurt.


Në përgjithësi pikturat e vizatimet e paraqitura në këtë ekspozitë treguan se sa gjini e vështirë është portreti dhe se për t'i hyrë një pune të tillë

nuk mjafton vetëm përgatitja profesionale, por duhet një angazhim i vërtetë e i vazhdueshëm krijues i të gjithë talentit të artistit.

Portretet e Dh. Trebickës, D. Jukniut, H. Agollit, Z. Shoshit, I. Lulanit, E. Hilës, M. Shehut, Ç. Cekës, Q. Prizrenit, P. Melles tregojnë në mënyra të ndryshme, me stile dhe mjete nga më të ndryshmet të shprehjes artistike se kemi të bëjmë me piktorë të përgatitur profesionalisht. Por pikturat e tyre të tërheqin më fort me ndonjë efekt koloristik, me ndonjë kër-



Dh. Trebicka: Fonditorja, vizatim



H. Agolli: I riu punëtor, vizatim

kim tepër modest të zgjidhjes kompozicionale se sa me karakterin e psikologjinë e punëtorëve të portretuar. Në «Me talurgun e ri» Ç. Ceka është prirur të shprehet me elegancë piktoreske për të na dhënë figurën e një punëtori që ende ruan tiparet e naivitetit fëmënor dhe që ka nisur të kalitet. Ndërsa në vizatimin e H. Agollit «I riu punëtor» zbulojmë një botë më të ndërlikuar shpirtërore të shoqëruar me nuancat e pasura piktorike që ka krijuar pena, Dh. Ligori në vizatimin «Fonditori» jep më fort dinamikën e punës në uzinë.

Mund të lavdëronim peizazhin «Në minierën e Manzës» të A. Fajës për ngrohtësinë materiale të pamjes, «Pejzazhin industrial» të K. Stavres për freskinë e tij pranverore, ndonëse ende të pa kultivuar sa duhet në disa ngjyra, dy peizazhet e N. Zajmit nga kantieret e Vaut të Dejës për një farë vërtetësie e gjallërie e ndonjë tjetër, por nuk duhet të harrojmë

më se kjo është një ekspozitë e portretit dhe se peisazhi është futur aty vetëm sa për ta pasuruar me ambjentet e punës.

Përveç pikturave, vizatimeve e grafikave, në ekspozitë kishte edhe ndonjë mozaik si «Minatori» i R. Karanxhës.

Me këtë rast dëshërojmë të bëjmë një vërejtje për titujt që u vihen disa herë ekspozitave. Titulli «Portret u klasës punëtore në artet figurative» siç u quajt ekspozita e 10 shkurtit, pa dyshim nuk është i gjetur sepse, kuptohet, në këtë rast nuk kishim të bënim as me një paraqitje abstraguese të të gjithë klasës punëtore as edhe me një pasqyrim të saj në të gjitha artet tona figurative në përgjithësi. Po kështu para disa kohe ekspozita e talenteve të reja u quajt «Rinia në punë e në jetë», a thua se ndër ne puna nuk bëka pjesë në jetën e rinisë.

Andon Kuqali



R. Karanxa: Minatori, mozaik

ESTRADAT PROFESIONISTE DHE ÇFAQJET PËR FËMIJË

Prej datës 14 janar deri më 3 shkurt në qytetet Shkodër, Pogradec dhe Sarandë u organizuan nga ana e Ministrisë së Arësimit dhe Kulturës dhe e komiteteve ekzekutive të K.P. të katëre rrethëve tre takime zonale të estradave profesioniste me temë për edukimin ideo-estetik të fëmijëve. Në këtë mënyrë, në forma të organizuara, u shkëmbye përvoja në krijimin e shfaqjeve skenike për të vegjëlit si një nevojë e domosdoshme shpirtërore.

Temat e përgatitura nga shokët Kudret Velça, Gjergj Vlasi dhe Bekim Gaçe mbi çështje të ndryshme të specifikës së estradave për fëmijë jo vetëm që u ndoqën me interes nga gjithë pjesëmarrësit, por dhe u kthyen në objekt diskutimi masiv, duke shkëmbyer në të njëjtën kohë përvojën e fituar në krijimin e katëre shfaqjeve.

Pra, ky ishte një takim pune për të çelur horizontet të reja në punën e përditëshme të estradave tona në drejtim të edukimit ideo-estetik të fëmijëve. Nuk u ndanë çmime dhe medaljone. Preokupimi kryesor ishte si dhe qysh të bëjmë për të krijuar shfaqje sa më të bukura, sa më të gëzueshme dhe edukuese për të vegjëlit tanë, filizët e rinj të socializmit në Shqipëri. Dhe ky qëllim u arrit. Të tre takimet u mbyllën me sukses, duke çelur udhë të reja në krijimtarinë skenike për fëmijë, drejt pasqyrimit të botës së tyre të madhe.

Është për t'u shënuar se në të tre takimet zonale u evidencuan tri shfaqje shumë të mira në përshtatje të plotë me botën e fëmijëve. Në takimin e

Shkodrës «startin» e arriti më mirë e më bukur estrada profesioniste e Tiranës «Cirk-Estradë» me regjizor-piktor B. Kapexhiun, e cila paraqiti një shfaqje ku gëzimi mpleksej me guximin fëmënor në një ambjent të ndritshëm, tërë fantazi e dritë. Në takimin e dytë, në Pogradec, doli në ballë estrada profesioniste e Durrësit me shfaqjen e Gj. Vlashit «Kush e ka radhën?», në të cilën spikati humori i çiltër i fatosave, i cili bashkoi si pa u kuptuar sallën me skenën, me një gjuhë të thjeshtë, të sinqertë e plot gaz e optimizëm. Ndërsa takimi i tretë, në Sarandë, renditi në krye estradën profesioniste të Vlorës me shfaqjen «Në botën e fëmijëve» të regjizorit M. Ferra dhe piktorit S. Xhaferi, ku komunikimi me botën e të vegjëlve bëhej me zhdërvjelltësi e humor përmes një sërë fabulash të inskenuara nga jeta e kafshëve, të cilat zhvilloheshin në një dekor të hijshëm e mjaft plastik. Pra, sidomos shfaqjet më të mira jo vetëm që paraqitën disa krijime me shumë vlerë të estradës sonë në përgjithësi, por treguan edhe konkretisht tri udhë të ndryshme, njera më e bukur se tjetra, në pasqyrimin e temës së fëmijëve.

Është për t'u shënuar se tematika e shfaqjeve të estradave që erdhën në këto takime pati larmi dhe përgjithësisht u përgjigjej kushteve të sotme të edukimit të fëmijëve tanë. Spikati sidomos problemi i edukimit të të vegjëlve përmes zbatimit të trekëndëshit revolucionar: mësim, prodhim, edukim fizik e ushtarak, duke kërkuar edhe njëloj përshtatje me të gjitha moshat. Nga ana tjetër,

në të gjithë problematikën u synua që pasqyrimi i tematikës për edukimin e fëmijëve të arrihej nëpërmjet harmonizimit të marrëdhënieve midis shkollës, familjes dhe shoqërisë. Ku më shumë e ku më pak zbërthimi i kësaj tematike dhe pasqyrimi i saj në skenë me mjetet e humorit dhe të satirës, duke u mbështetur në specifikën e shfaqjeve për fëmijë, ndihmoi që spektatorët e vegjël të marrin një edukatë të shëndetëshme dhe njëkohësisht të argëtohen ashtu siç na porositi Partia dhe shoku Enver.

Po krahas sukseseve këto takime nxorën edhe një varg problemesh që kanë të bëjnë si me specifikën e estradës për fëmijë, mjetet shprehëse, veçorinë e moshave, ashtu edhe me nivelin ideologjik e artistik të shfaqjeve. Një nga problemet më të mprehta që ai i raportit midis shembullit pozitiv dhe atij negativ në shfaqjet për fëmijë. Duke u nisur nga natyra e perceptimit të sendeve dhe fenomeneve të botës reale nga fëmija, u pa e domosdoshme që në shfaqjet e estradave për të vegjëlit t'i jepet më shumë rëndësi pasqyrimin të shembullit pozitiv përmes situatave humoristike, fantazisë feminare etj., në mënyrë që spektatori i vogël të ketë mundësi të imitojë drejtpërsëdrejti të mirën, shembullin pozitiv dhe t'i kundërvihet direkt të keqes, duke e luftuar atë nga pozita të qarta dhe njëkohësisht të thjeshta. Ky problem u bë edhe më i rëndësishëm meqënëse në disa shfaqje zotëronte shembulli negativ si objekt i humorit e satirës, gjë që e vështirësonte mjaft ndikimin edukativ tek fëmijët, aq më tepër kur tipi negativ bëhej tërheqës dhe fitonte duartro-

kitjet e të vegjëlve. Zgjidhjen më të mirë të këtij raporti, pa kaluar në ekstremitet të njerës apo të tjetrës, e dhanë më mirë shfaqjet që përmendëm më lart.

Problemi tjetër lidhet me zbulimin e botës feminare dhe ngjitjen e saj në skenë me mjete shprehëse të kuptueshme, të thjeshta e të shumta. Megjithatë në shfaqjet më të mira pati një kontakt të menjëhershëm me spektatorët e vegjël, prapëseprapë, në disa drejtime doli problemi i njohjes më të madhe të botës së fëmijëve. Kjo çështje nis që nga lufta kundër moralizimeve të thata, deklarative e mbaron në përcaktimin e mjeteve artistike, që duhen përdorur për ta bërë shfaqjen më të afërme për botën e të vegjëlve. Fëmijët kanë nevojë për shfaqje plot fantazi ku të gjejnë shprehje ëndërrat e tyre dhe bota të zbulohet me tërë diapazonin e saj. Për këtë duhen përdorur jo vetëm gjini të ndryshme, -si inskenimi i përrallës, legjendës, fabulës si dhe tablo nga bota reale, por edhe këndi i vështrimit të artistit të përfshijë mjetet më të larmishme figurative, ngjyrat më të pasura e më të bukura. Suksesi i merituar i estradave të Tiranës, Durrësit dhe Vlorës shpjegohet pikërisht për shprehjen me fantazi të botës së fëmijëve, e cila u zgjon kënaqësi ideo-estetike bile edhe baballarëve.

Natyrisht problemet janë të shumta. Këto takime domosdo nuk i zgjidhin të tëra, po praktika skenike, diskutimet, me siguri do të sugjerojnë edhe rru-gëzgjdhje të reja.

Miho Gjini

DISKUTIMI I FESTIVALIT TË KËNGËS NË RADIO-TELEVIZION

Diskutimin krijues të festivalit të IX të këngës në radio-televizion, organizuar nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë së bashku me Drejtorinë e Radio-difuzionit, që u zhvillua në fund të janarit, e filloi Gjon Simoni.

Ai bëri një vlerësim panoramik të këngëve dhe të problemeve që u dalin duke i kategorizuar në tipa të ndryshëm: me karakter epiko-heroik, me karakter lirik, të tipit popullor, të tipit ritmik e të tjera. Me vlerësimin e tij se «larmia tematike dhe emocionale krijon tabllonë e këtij festivali» dhe se «në këngët e ndryshme të tij gjejnë pasqyrim emocionant dhe mendimet e kohës së njerëzve tanë» u pajtuan të gjithë diskutantët.

Gjon Simoni tha gjithashtu se «karakteristika në këngët e këtij festivali që se ato shprehin ndjenja më të ngrohta, emocionaliteti i tyre ishte më i afërt dhe më depërtues tek dëgjuesit. Nuk kishin vend në këtë festival emocionet dhe efektet e jashtëme». Kjo ka të bëjë me fytyrën e këngës sonë dhe me kornizën që duhet të ketë festivali i radio-televizionit. Por toni pompoz, deklarativ i disa këngëve, si dhe zyrtarizmi sipas të cilit në festival duhet të bëhet një ekspozim i të gjitha gjinive të muzikës së kënduar kanë përbërë dobësitë e festivaleve, që ndonëse më pak, u dukën edhe në të nëndin (diskutimet e T. Harapit, Ç. Zadejës, P. Gacit etj.).

Duhet përshëndetur gjithashtu prirja që u vu re më

shumë kësaj radhe për të shkruar këngë të thjeshta, që përvetësohen dhe këndohen nga masat. Sipas mendimit të N. Zoraqit këngët e lehta e të thjeshta shprehin mendime lirike e gazmore, kurse mendimet e mëdha shprehen me forma të mëdha. Por s'ka gjë më të mirë, në qoftë se me pak, mund të themi një mendim të madh si me këngën e F. Ibrahimit, (tekst popullor) «Ku po shkon, o partizan» (Ç. Zadeja). Disa nga pjesëmarrësit në diskutim si T. Harapi ishin të mendimit që festivali të jetë vetëm i këngës së lehtë, pa gjini të rënda në formën e arievë, romancave e kantatave që mund të këndohen në koncerte, mbrëmje akademike e të tjera raste. Por festivali i radio-televizionit duhet t'i paraqesë të gjitha llojet e këngëve, sepse të vështira për të kënduar janë edhe «Shtëpia e partisë» e N. Zoraqit edhe «Mesnat» e Sh. Kushtës. Rëndësi ka që kënga e festivalit të jetë këngë (H. Stringa). Në festival duhet të gjejnë shprehje ndjenjat e të gjithë njerëzve tanë të rinj e të moshuar, të çdo kategorie shoqërore (L. Dizdari).

Kënga jonë e re mbështetet në muzikën popullore. Është e vërtetë se populli i ka kënduar në mënyrë të mrekullueshme, thjeshtë e me ndjenjë të thellë jetës e ngjarjeve të kohës (B. Kongoli), por edhe kënga jonë e re, në tërësinë e saj, ashtu si edhe në festival ka krijuar fizionominë e vet, ka fituar tipare të reja shprehëse të realitetit socialist, revolucionar. (H. Stringa).

Duhet të marrë fund një herë e mirë praktika e shumë

kompozitorëve që shkruajnë më parë muzikën dhe asaj i përshtasin pastaj një tekst. Ky është shkaku që në shumë raste fjalët nuk lidhen me muzikën, janë të paqarta ose të ftohta (Ç. Zadeja), është vështirë të këndohen me diksion të pastërt ose ritmi nuk përputhet me theksin tonik (G. Çako).

Ndonëse sivjet në festival morën pjesë forcat tona më të mira poetike në ende nuk kemi tekst dinjitoz poetik të këngës (F. Arapi).

Një problem me rëndësi është interpretimi. Përveç këngëtarëve tanë me eksperiencë si Vaçe Zela, Qemal Kërtusha e ndonjë tjetër, këngëtarët e tjerë nuk erdhën të përgatitur profesionalisht, bile në disa raste kishin rënë, po t'i krahasojë me festivalet e mëparëshme. Radioja duhet të ma-

rrë përsipër edukimin dhe stërvitjen e këngëtarëve të rinj e sidomos të amatorëve. Nga ajo rrjedh edhe që këngët interpretohen njësoj ose imitohen një a dy këngëtarë (Ç. Zadeja).

Formacionet orkestrale të festivalit qenë tre: orkestra simfonike, orkestra e frymës dhe kompleksi i kitarave. Ndofta do të jetë më mirë të ketë formacione më të thjeshta, si ato që kanë shtëpitë e kulturës e qendra të tjera, në mënyrë që kënga të mund të përhapet më lehtë.

Ashtu siç e theksoi, në fund, edhe Hamide Stringa, sekretare e Lidhjes për muzikën, ky qe një diskutim i dobishëm ku problemet e rëndësishme të këngës u trajtuan me preokupacion të vërtetë.

Korespondenti i «Nëndorit»

DISKUTIMI I «KËSHTJELLËS»

Më 5 shkurt u bë një diskutim krijues për romanin «Kështjella» të Ismail Kadaresë. Në një referat të studjuar Vasil Mele bëri analizën e hollësishme të romanit, vuri në dukje vlerat e tij ideestetike dhe notën e re që sjell në tërë zhvillimin e letërsisë sonë të realizmit socialist.

«Ideja themelore, tha ai duke u marrë me procesin krijues të autorit, që do të përbënte dhe që përbën në fakt qëndrën e romanit, mendoj se është po ajo që shihet, me nuanca të ndryshme, edhe te poema «Përse mendohen këto male» edhe te romani «Gjenerali i ushtrisë së vdekur»: disfata e armiqve, sado të fu-

qishëm dhe të tmerrshëm që mund të ishin ata, dhe pathyeshmëria e popullit tonë».

Vetë mënyra e ndërtimit të këtij romani, trajtimi i fenomeneve në plan novator, idetë e mëdha që shtjellon dhe mënyra e zgjidhjes që i ka dhënë autori, tërhoqën vëmendjen e diskutantëve dhe u bënë objekt debatesh.

Agim Cerga theksoi se «Kështjella» për vlerat e mëdha ideo-estetike shënon një sukses të ri në prozën tonë. Pasi vuri në dukje se merita më e madhe e autorit qëndron në zgjidhjen e drejtë të raportit midis përshkrimit historik dhe zbërthimit të logjikës së historisë, ai nënvizoi disa nga mo-

mentet më të bukura të veprës si portretet kolektive të pikturuara me mjeshtëri, skenat masive të dhëna me një vërtetësi të rrallë, fundin e Tursun Pashait si momentin kulminant të romanit etj. Por ai vuri në dukje gjithashtu se disa herë personazhet flasin me koncepte etike që nuk janë të turqve të shekullit XV, por të kohës tonë. Sipas mendimit të tij, fjalët e kështjellarit, zëri i të cilin është një gjetje e bukur artistike, — ai është zëri i Adheut që vjen tek ne, — kur merren me hollësi të vogla humbasin atë tingëllimin e madh filozofik që duhet të kenë gjithnjë.

Koço Bihiku theksoi se autori i «Kështjellës» ka ditur të zbulojë mirë paralelizmin historik, se merita e madhe e shkrimtarit është historizmi. Ai tha se duke na dhënë një vepër që dëshmon për elasticitetin e mendimit të tij poetik, Ismail Kadareja ka ditur të pasqyrojë në mënyrë realiste atë kohë, të japë thelbin agresiv, feudal, shkatërrues të ushtrisë otomane, dekadencën e saj dhe se populli shqiptar ka një vitalitet të tillë që mund të përballojë çdo situatë. Por Koço Bihiku tha se shiu fut në roman motivin e rastësisë, gjë që nuk përbën një zgjidhje të drejtë, sepse fitorja e kështjellarëve merret si rastësi. Ai kërkoi, vec kësaj, si të domosdoshme, paraqitjen e figurave të luftëtarëve shqiptarë. Ai bëri pyetjen se përse prania e karaktereve shqiptare do ta vinte romanin në një plan tjetër?

Afër me këtë mendim ishte edhe Klara Kodra e ndonjë tjetër, e cila tha gjithashtu se paraqitja e kështjellës dhe e shqiptarëve në mënyrë simbolike u jep këtyre një pamje të papërcaktuar dhe enigmatike.

Sikundër edhe Agim Cerga

që hodhi poshtë interpretimin simbolik të dështimit të fëmijës së Tusun Pashait nga gruaje e haremit nëmbarim të romanit, «një mbarim, tha ai, shumë i bukur» edhe Maks Velo, Kiço Blushi, Ruzhdi Pulaha, Resul Bedo, përveç të tjerëve, mbrojtën mendimin se nuk ishte i nevojshëm në këtë roman dhe në këtë formë të tij, një paraqitje më e gjërë dhe më e hollësishme e kështjellarëve, e shqiptarëve ose e figurës së Skënderbeut dhe se në këtë mënyrë ata dalin të fuqishëm, bindës, madhështorë e të pathyeshëm.

Abdurrahim Myftiu theksoi se diskutimi i romanit «Kështjella» ka rëndësi të madhe për vetë faktin se si duhet ta kuptojmë në të ardhmen temën historike. Duke u ndalur shkurtimisht mbi karakterin dhe rolin e romanit historik ai sqaroi se në veprën e re të Ismail Kadaresë nuk kemi as modernizim të historisë as një ilustrim të saj. Pasi zbërtheu idenë e «Kështjellës» ai polemizoi me Koço Bihikun, i cili në analizën e romanit i quajti të gabuara paraqitjen e kontradiktave brenda kampit turk, të figurave të ushtarëve të mjerë turq, e interpretoi përshkrimin realist të Tursun Pashait dhe fundin e tij tragjik si shprehje e një keqardhjeje për të. Abdurrahim Myftiu tha se kjo në fund të fundit është ta mohosh këtë vepër, kurse autori ka bërë aty anatominë e armikut dhe Tursun Pashai shihet me ironi.

Duke u marrë me interpretimin e shiut disa diskutantë me radhë vunë në dukje se ai jo vetëm që nuk përfaqëson rastësi dhe është një shi disfate, por ka një kuptim të thellë dhe lidhje me një të vërtetë historike. Veç kësaj, në momentin që shiu futet si element artistik, disfata e ushtri-

së osmane është e plotë, është kryer, dhe ai vetëm e shoqëron.

Konkluzioni i diskutimeve ishte se qëllimi i autorit është të japë fytyrën e vërtetë, çnjerezore të agresorit dhe disfaten e tij. Kapitullimi i armikut para kësaj kështjelle të pamposhtur është dhënë me sukses, me forcë të madhe.

Në fund, autori i «Kështjellës» Ismail Kadareja, duke falenderuar të pranishmit për

pjesëmarrjen në diskutim dhe për vrejtitet që i bënë, sqaroi se si ndërmjet shkrimtarit e lexuesit duhet të ketë lidhje të drejta. Shkrimtari faktet, elementet e ndryshëm i ka marrë nga historia, nga dokumentat historike dhe nuk i ka krijuar vetë si simbole. Ato janë simbole vetëm kur jeta, ngjarjet, historia, i kanë bërë të tilla.

Korespondenti i «Nëndorit»

Adresa: Tiranë, Rr. Konferenca e Pezës — Tel. 30-16

Pajtimet: 6 muaj lekë 16,5, 1 vit: lekë 33.

Tirazhi: 3500 Formati: 56 x 96 1/16 Stash: 2204-65

Shtyp. N.I.S.H. Shtypshkronjave «MIHAL DURI» — Tiranë